



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”
Kolegji Universitar “Logos”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Fatmir Guri

2. Prof. Asoc. Dr. Gentjan Mehmeti

Maj/2025

Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në
“Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës
Bujqësore”

1	IAL aplikues:	KU LOGOS
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Agrobiznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 405, Datë 25.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr.93, datë 06.03.201720 %, me Vendim Senati Nr. 1, datë 10.03.2022, miratuar me shkresë të MASR Nr. 2380/3 Prot., datë 30.05.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr. 219, datë 26.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	BA Nr. 38, datë 22.04.2022
8	Cikli i studimit:	Diplomë Profesionale
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestre
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	NA
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	NA
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024 10 PAE 4 PAK 2022-2023 9 PAE 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2023-2024 2 studente 2022-2023 1 studente
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Kolegji Universitar “LOGOS” (në vijim, KU LOGOS) është një institucion privat i arsimit të lartë që operon në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky institucion u themelua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1055, datë 29.07.2009, dhe u riorganizua me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit (UMAS) Nr. 93, datë 06.03.2017, për miratimin e statutit të tij.

KU LOGOS është i strukturuar në tre fakultete kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
2. Fakulteti Ekonomik
3. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor

Fakulteti Ekonomik ofron disa programe studimi në departamentet përkatëse, duke përfshirë:

- **Departamenti i Financë-Kontabilitetit:**
 - Cikli i parë: Bachelor në “Financë-Kontabilitet”
 - Cikli i dytë: Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”
- **Departamenti i Menaxhimit:**
 - Cikli i parë:
 - Bachelor në “Menaxhim Biznesi”
 - Bachelor në “Menaxhim Turizmi”
- **Departamenti i Agrobiznesit:**
 - Cikli i parë: Diplomë Profesionale në “Agrobiznes”

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit “**Diplomë Profesionale në Agrobiznes**”, i cili ofron dy profile: “**Marketing i Produktit Bujqësor**” dhe “**Menaxhim i Fermës Bujqësore**”. Programi i studimit është ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit në Fakultetin Ekonomik dhe është licencuar me Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 405, datë 25.07.2019.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi realizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, si dhe aktet nënligjore përkatëse, përfshirë Statutin e KU LOGOS dhe Rregulloren e programit të studimit.

Stafi akademik i angazhuar në programin profesional në Agrobiznes vlerësohet për përkushtimin dhe përvojën e tij në procesin mësimor, duke kontribuar në ofrimin e një niveli të mirë të cilësisë akademike. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi ka nevojë për përmirësime thelbësore, veçanërisht në përmbajtjen dhe strukturën e moduleve, të cilat aktualisht nuk reflektojnë në mënyrë të plotë objektivat formues dhe natyrën profesionale të diplomës së ofruar. Përputhshmëria ndërmjet lëndëve, titullit të programit dhe nevojave të tregut të punës duhet të rishikohet me kujdes, me qëllim që studentët të pajisen me kompetenca të zbatueshme dhe të përshtatshme për profilin që synon ky program

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm:

Procesi i vlerësimit të jashtëm në Diplomën Profesionale në “Agrobiznes”, me profilet “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti Ekonomik) pranë KU LOGOS, nisi me trajnimin, prezantimin dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ). Më pas, ky grup, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e **Raportit të Vlerësimit të Brendshëm**, si dhe dokumenteve mbështetëse përkatëse. Gjatë kësaj faze, grupi i vlerësimit të jashtëm nxorri në pah një sërë pikash diskutimi lidhur me procedurat, standardet dhe kriteret e akreditimit, të cilat do të ishin pjesë e diskutimit dhe do të sqaroheshin gjatë takimeve në institucionin e arsimit të lartë (IAL).

Vizita dy ditore në KU LOGOS u zhvillua më **18-19 Tetor 2024**, gjatë së cilës GVJ realizoi takimet e planifikuara sipas agjendës së miratuar. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me:

- Përgjegjësin e Departamentit të Agrobiznesit dhe Dekanin e Fakultetit Ekonomik,
- Përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,
- Përfaqësuesit e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, të pranimeve dhe këshillimit për karrierën,
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm,
- Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këtë program studimi,
- Përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore,
- Sekretarinë mësimore etj.

Gjatë takimeve, u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit, duke u fokusuar në aspektet që kërkonin informacion shtesë për të mundësuar kuptueshmërinë e praktikave të ndjekur dhe përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pas përfundimit të vizitës në IAL, GVJ vijoi punën për hartimin e **Raportit të Vlerësimit të Jashtëm**, duke u bazuar në dokumentacionin e siguruar dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe inspektimeve në institucion. Në përfundim të këtij procesi, draft-raporti iu dorëzua ekspertit përkatës të ASCAL për shqyrtim dhe vlerësim të mëtejshëm.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Anilda Beqiraj.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 38, datë 22.04.2022 janë

1. Institucioni të shikojë përmbajtjen e lëndëve të planit mësimor të këtij programi studimi me qëllim përshtatjen e njohurive të tyre me ciklin e studimit të këtij programi studimi.
2. Institucioni të përfshijë në kurikulën e programit të studimit lëndë të marketingut me qëllim arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të të nxënit që ky program studimi synon
3. Institucioni të rishikojë përmbajtjen e lëndëve të lidhura me profilin e menaxhimit të fermës bujqësore me qëllim përfshirjen në to të temave që lidhen me produktet kryesore të bujqësisë shqiptare, siç janë bimët aromatike dhe mjekësore, parimet e serave, dhe blegtoaria.
4. Institucioni të rishikojë syllabuset e këtij programi studimi me qëllim përfshirjen e dosjes praktike të studentëve, si dhe kompetencat e fituara nga studentët gjatë praktikës
5. Institucioni të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi me qëllim që raporti teori/praktikë të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi
6. Institucioni të pasurojë dhe përditësojë fondin e literaturës së bibliotekës me botime të viteve të fundit, në funksion të këtij programi studimi

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Megjithë përpjekjet institucionit, programi i studimit përsëri ruan karakteristikat e nivelit të një programi të ciklit të parë 3 vjeçar të studimeve duke tejkaluar nivelin e studimit të programit.
2. Ky rekomandim është plotësuar
3. Ky rekomandim është plotësuar.
4. Ky rekomandim nuk është plotësuar, praktika mësimore e studentëve zhvillohet si një modul më vete dhe jo si pjesë e çdo moduli.
5. Raporti teori praktikë është sipas parashikimeve të akteve nënligjore në nivelin 50%/50%, por kjo ndarje është artificiale e cila nuk mbështetet në organizimin e moduleve të cilët të jenë të lidhur një mësimdhënie më praktike. Ato mbeten në kuadrin e moduleve klasike universitare.
6. Ky rekomandim është plotësuar.



Kolegji Universitar Logos është njohur me DRVJ më datë 02.05.2025, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 62/17 Prot date 22.04.2025.

Kolegji Universitar dërgon komente datë 06.05.2025. me shkresë Nr 108/1

Kolegji nuk ka komente, drafti kalon në Raport Final.

Two handwritten signatures in blue ink, one on the left and one on the right, positioned below the page number.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Programi i Studimit me Karakter Profesional “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Diploma Profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, me profilet “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i Produktit Bujqësor” synon që të ofrojë specialistë të cilët kanë si qëllim që të kontribuojnë në njërin prej fushave prioritare të zhvillimit të vendit siç është bujqësia. Ky program studimi i drejtuar nga administrimi i fermave dhe ndërmarrjeve bujqësore, administrimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore, blegtorale dhe të agropërpunimit për misionin dhe qëllimin e tij nuk ka asnjë element i cili mund të bjerë në kundërshtim me interes kombëtare, apo të kërkojë minimin e vlerave akademike kulturore kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas dokumentacionit të dorëzuar, programet e studimit të ofruara në Kolegjin Universitar “LOGOS” janë hartuar në përputhje me Planin Strategjik 2018-2024 (<i>Shtojca Dosja Nr.1</i>). Ky plan është i orientuar drejt zhvillimit të kurikulave dhe metodave të mësimdhënies, avancimit të kërkimit shkencor, forcimit të partneriteteve dhe promovimit të ndërkombëtarizimit të institucionit, duke marrë parasysh dinamikat dhe kërkesat e shekullit të 21-të. Në veçanti, për programin Diplomë Profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, me profilet “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i Produktit Bujqësor”, theksi është vendosur në forcimin e bashkëpunimit me institucione publike dhe private nga sektorë të ndryshëm. Kjo qasje synon t’u ofrojë studentëve mundësi për praktika profesionale dhe t’i orientojë ata drejt tregut të punës pas përfundimit të studimeve (<i>Shtojca Dosja Nr.1, fq. 22-23</i>).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e	Programet e studimit profesional dy-vjeçar në “Agrobiznes”, konkretisht “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” dhe “Marketingu i Produktit Bujqësor”, ofrohen nga Departamenti i Agrobiznesit në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (MARS), sipas Urdhrit Nr. 405, datë 25.07.2019. Këto programe janë pjesë e Fakultetit Ekonomik të

drejtimet akademike të tij.	Kolegjit Universitar "LOGOS".
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Për ofrimin e programeve të studimeve profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, "Menaxhim i Fermës Bujqësore" dhe "Marketing i Produktit Bujqësor" është kryer një studim tregu në vitin 2018 i cili citohet në Raportin e vlerësimit të brendshëm, por nuk është pjesë e dokumenteve mbështetëse të paraqitura nga institucioni. Përtej sa më sipër, programi i studimit ka një numër të ulët studentësh dhe njëri prej profileve të tij nuk është aktivizuar si pasojë e preferueshmërisë së ulët nga ana studentëve potencialë. Në këtë kuadër, institucioni duhej të kishte bërë një analizë të thellë për të kuptuar kërkesat e tregut të punës që do të rriste kërkesat për këtë program studimi. Pra në këto kushte mungon një zhvillim i kurikulës nga ana e institucionit sipas kërkesave të tregut të punës, që është akoma edhe më e domosdoshme për një program profesional siç është programi në fjalë.
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Kolegji Universitar "Logos" ka krijuar një kornizë institucionale që përfshin dokumente rregullative, struktura mbështetëse dhe bashkëpunime me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe aktorë të sektorit. Në këtë kuadër, institucioni ka demonstruar një nivel përvoja dhe përpjekjeje organizative për të mbështetur këtë program në aspektin akademik dhe administrativ. Megjithatë, analiza e përmbajtjes së programit, e syllabuseve, e stafit të angazhuar dhe e metodave të mësimdhënies tregojnë se kapacitetet aktuale nuk janë ende të mjaftueshme për të garantuar një ofertë akademike tërësisht të përshtatur me natyrën praktike dhe profesionale të programit. Personeli akademik ka profil të orientuar më shumë drejt menaxhimit të përgjithshëm, me një përfaqësim të kufizuar të ekspertizës në bujqësi dhe teknologji agro-ushqimore. Për më tepër, mungon një reflektim konkret i metodave moderne dhe të integruara të mësimdhënies në dokumentet themelore të programit. Gjithashtu, kapacitetet infrastrukturore dhe burimet didaktike (si literaturë bashkëkohore dhe akses praktik në biznese bujqësore) janë ende të pamjaftueshme për të siguruar zhvillimin e kompetencave teknike dhe të zbatueshme në përputhje me profilin profesional që synon programi. Rekomandohet që institucioni të forcojë përbërjen e stafit akademik me ekspertë të fushës bujqësore, të përditësojë përmbajtjen dhe literaturën mësimore, si dhe të krijojë marrëveshje të qëndrueshme me biznese bujqësore për

	komponentin praktik të studimeve. Vetëm përmes përmirësimeve të tilla do të mund të arrihet një nivel i qëndrueshëm dhe cilësor për ofrimin e këtij programi studimi.
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit me karakter profesional 2-vjeçar në “Agrobiznes”, me profilet “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, është në përputhje të plotë me drejtimet akademike dhe veprimtarinë kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të Fakultetit Ekonomik në Kolegjin Universitar “Logos”. Fakulteti Ekonomik është i strukturuar në tre departamente: Departamenti i Financë-Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Agrobiznesit. Një nga objektivat kryesore të këtij fakulteti është përgatitja e ekonomistëve me aftësi të larta, të gatshëm për të vijuar studime të mëtejshme akademike dhe për të përballuar sfidat e tregut konkurrues të punës. Vetë programi i studimit ka si mision formimin e specialistëve në sektorin e agrobiznesit. Këto programe ofrojnë mundësi për t’u njohur në mënyrë konkrete me marketingun e produkteve bujqësore, proceset e agro-përpunimit, menaxhimin e fermave bujqësore, proceset e agropërpunimit, etj. Lëndët e përfshira në programin profesional 2-vjeçar në “Agrobiznes” ofrohen nga personel akademik me status të përhershëm dhe të kontraktuar të Departamentit të Agrobiznesit, si pjesë përbërëse e Fakultetit Ekonomik. (Shtojce nr 9. Struktura organizative e IAL 1.pdf, Shtojca nr. 2: Dosja e programit të studimit) Pavarësisht se informacioni i vënë në dispozicion nga institucioni nuk na paraqet një pamje të plotë rreth ngarkesës dhe specializimit për secilin prej pedagogëve si edhe kërkimit shkencor të zhvilluar prej tyre për të qenë në përputhje me modulet të cilat ato mbulojnë. Kërkimi shkencor në fusha të cilat lidhen me programin e studimit është i kufizuar dhe jo tërësisht i lidhur me fushat e kërkimit të cilat kanë të bëjnë me administrimin e biznesit apo me marketingun e produkteve bujqësore (Shtojce nr 21. Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet në nivel programi.pdf). Ky është një kufizim i cili duhet të kihet në konsideratë nga ana e institucionit .
Konkluzione	Programi është në harmoni me misionin dhe qëllimet institucionale, duke mbështetur vlerat akademike dhe kulturore kombëtare dhe duke kontribuar në një sektor prioritar për zhvillimin kombëtar siç është bujqësia. Programi është dizajnuar në përputhje me strategjinë institucionale të zhvillimit,

	duke synuar integrimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet bashkëpunimeve me sektorët publikë dhe privatë, por ekziston një nevojë për rishikim të qasjes ndaj tregut për të rritur atraktivitetin e profileve të ofruara. Stafi akademik paraqet mangësi në ekspertizën specifike të sektorit të bujqësisë dhe teknologjive agro-ushqimore. Gjithashtu, ka mungesë në reflektimin e metodave moderne dhe integrimin praktik të mësimdhënies, çka është një element kyç për natyrën e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Funksionimi, mbikëqyrja dhe marrëdhëniet institucionale të personelit dhe stafit akademik të programeve të studimit profesional dy-vjeçar, “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” dhe “Marketingu i Produktit Bujqësor” janë të rregulluara përmes akteve të brendshme të institucionit. Këto përfshijnë Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Agrobiznesit, Rregulloren e Fakultetit Ekonomik, Rregulloren e Kolegjit Universitar “LOGOS”, si dhe dokumente të tjera të rëndësishme si Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Politika e Cilësisë dhe Analiza Vjetore e Departamentit (Shtojca Dosja nr.1 - Rregullore e përgjithshme e KU “LOGOS”.pdf, Shtojca Dosja nr.1-Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, Kolegji Universitar “Logos” ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si në fushën akademike – për shembull me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin “Fan Noli” të Korçës – ashtu edhe me institucione private për realizimin e praktikave mësimore. (Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset pdf, Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me IAL brenda dhe jashtë vendit.pdf).
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,	Institucioni ka finalizuar marrëveshje bashkëpunimi me disa agrobiznese, të cilat përbëjnë një mundësi shumë të mirë jo

institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	vetëm për kryerjen e praktikave profesionale, por edhe për ndërtimin e një bashkëpunimi më të thelluar. Këto bashkëpunime duhet të shtrihen përtej praktikave rutinë dhe të shfrytëzohen si burim për zhvillimin e rasteve studimore konkrete, si dhe për adresimin e problematikave që lindin nga vetë praktika në terren. Kjo qasje do të ndihmonte ndjeshëm në forcimin e njohurive praktike të studentëve dhe lidhjen më të ngushtë të formimit të tyre me realitetin e tregut të punës (<i>Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me bizneset.pdf</i>, <i>Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me IAL brenda dhe jashtë vendit.pdf</i>).
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, institucioni deklaron se kryen një analizë periodike të efekteve pozitive që sjellin bashkëpunimet me institucionet partnere. Megjithatë, në dokumentacionin shoqërues mungonin evidenca konkrete që të vërtetonin realizimin dhe përmbajtjen e këtyre analizave. Pavarësisht kësaj, vlen të theksohet se prania e disa pedagogëve të jashtëm, të cilët vijnë nga institucione të arsimit të lartë me të cilat KU "Logos" ka marrëveshje bashkëpunimi, është një tregues i qartë i efektivitetit real që kanë pasur këto bashkëpunime, veçanërisht në forcimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Institucioni tregon angazhim për mbështetjen e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve të tij përmes pjesëmarrjes në panairë të ndryshme punësimi, si dhe duke financuar pjesëmarrjen e studentëve dhe të anëtarëve të rjetit Alumni në këto aktivitete. Kjo është një praktikë pozitive që kontribuon në nxitjen e lidhjeve me tregun e punës dhe në krijimin e mundësive për zhvillim profesional. Megjithatë, duhet theksuar se numri relativisht i ulët i studentëve të regjistruar në programe e bën këtë përpjekje më pak domethënëse në terma të ndikimit të gjerë dhe efektivitetit statistikor (<i>Shtojce nr 33. 1 - Mbeshtetje per studentet.pdf</i>, <i>Shtojca nr. 94 - Pjesemarrja ne Panaireset e Punes.pdf</i>).
Konkluzione	Në përmbushje të kërkesave të kritereve të vlerësimit, Kolegji Universitar "Logos" ka ndërmarrë përpjekje të dukshme për të rritur dhe zgjeruar bashkëpunimin institucional si në planin e brendshëm, nëpërmjet strukturimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësisve mes njësive akademike, ashtu edhe në planin e jashtëm, përmes marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë dhe me agrobiznese partnere. Këto bashkëpunime synojnë jo vetëm mbështetjen e realizimit të praktikave mësimore, por edhe ndërtimin e një bashkëpunimi më të thelluar që përfshin

	<i>raسته studimore dhe trajtimin e problematikave reale nga praktika, duke përmirësuar kështu cilësinë e formimit profesional të studentëve. Prania e pedagogëve të jashtëm nga institucionet partnere dhe angazhimi i institucionit në panaireset e punësimit përmes mbështetjes financiare të studentëve dhe të diplomuarve janë dëshmi të një qasjeje pozitive dhe të orientuar drejt tregut të punës. Megjithatë, këto përpjekje zhvillohen brenda kufizimeve që sjell një program studimi me numër të kufizuar studentësh, çka ndikon në dimensionin e gjerë të ndikimit dhe e bën efektin e përgjithshëm të këtyre bashkëpunimeve më të kufizuar në aspektin statistikor dhe institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Kolegji Universitar “LOGOS” ka hartuar politika, ka ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, Neni 103, si dhe me aktet e brendshme rregullatore (<i>Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf, Politika për sigurimin e cilësisë.pdf</i>). Në këtë kuadër, institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Cilësisë (<i>Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucioni.pdf</i>), të cilat funksionojnë mbi bazën e Rregullores për Sigurimin e Cilësisë dhe dokumentit të “Politikës për Sigurimin e Cilësisë”, të miratuar nga Senati Akademik. Megjithatë, përtej funksionimit të këtyre strukturave, institucioni duhet të konsiderojë zhvillimin e mjeteve më të përshtatshme për vlerësimin e cilësisë, në përputhje me natyrën dhe përmasat e vogla të programeve të studimit profesional. Në këtë kontekst, zëvendësimi i metodave tradicionale të vlerësimit – si pyetësorët standardë – me forma më interaktive e cilësore, si grupet e

	fokusit me studentët dhe pedagogët, do të mundësonte një qasje më të thelluar, fleksibël dhe efektive për identifikimin e problematikave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo do të përforconte në mënyrë më reale marrëdhënien midis strukturave të brendshme të cilësisë dhe nevojave konkrete të studentëve në një kontekst me numër të kufizuar pjesëmarrësish.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. (<i>Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf, Politika për sigurimin e cilësisë.pdf</i>). Në këtë kuadër, janë përcaktuar qartë përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përkatëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet (<i>Shtojca Dosja nr.1 -Plani Strategjik i Kolegjit Universitar Logos, 2018-2024.pdf</i>). Për zbatimin dhe monitorimin e këtyre mekanizmave funksionojnë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Cilësisë, të cilët sigurojnë që veprimtaria e institucionit të përputhet me standardet shtetërore të cilësisë. Vlen të theksohet se në përbërje të kësaj njësie është përfshirë edhe një ekspert i jashtëm (<i>Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucioni.pdf</i>). Si përfundim, mund të konkludohet se institucioni e ka të ngritur dhe funksional Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me kërkesat ligjore.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Sigurimi i cilësisë për programin e studimit me karakter profesional në Agrobiznes realizohet përmes mekanizmave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet shtetërore të arsimit të lartë. Programi ka kaluar procesin e akreditimit periodik, duke dëshmuar përkushtimin e institucionit ndaj ruajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së tij. Në këtë kontekst, institucioni ka zhvilluar dhe përditëson në mënyrë të rregullt paketën e instrumenteve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, duke përfshirë indikatorë, forma të raportimit dhe materiale mbështetëse që shërbejnë për monitorimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe procesit mësimdhënës. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së akreditimit, u konstatua se disa prej dokumenteve të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm nuk ishin të përfshira në dosje, duke kufizuar kështu verifikimin e drejtpërdrejtë të të gjithë procedurave të zbatuara. Pavarësisht kësaj, diskutimet me stafin përgjegjës për sigurimin

	e cilësisë konfirmuan se brenda institucionit ekziston një procedurë e konsoliduar dhe funksionale për realizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, e cila mbështetet në përfshirjen aktive të strukturave përgjegjëse dhe në përdorimin e praktikave të qëndrueshme të monitorimit dhe reflektimit institucional.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri, institucioni ka ndërtuar një qasje të unifikuar për sigurimin e cilësisë, e cila zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha programet e studimit që ofron. Kjo përfshin përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të cilët shërbejnë për të pasqyruar gjendjen aktuale, për të evidentuar arritjet dhe për të identifikuar dobësitë. Këta tregues janë të përcaktuar edhe në aktet rregullatore institucionale dhe përbëjnë bazën për ndërmarrjen e masave për përmirësim, përfshirë edhe promovimet apo nxitjet për performancë të lartë. Megjithatë, duhet theksuar se kjo qasje e përgjithshme nuk merr në konsideratë në mënyrë të veçantë karakteristikat specifike të programit profesional të studimit në Agrobiznes. Ky program ka një natyrë të veçantë për shkak të kohëzgjatjes më të shkurtër (2-vjeçare), profilit të ndryshëm të studentëve të rekrutuar dhe qasjes praktike të studimit. Kjo e bën të domosdoshme që institucionit t'i kërkohej përshtatja e qasjes së tij të vlerësimit të cilësisë, duke integruar instrumente dhe tregues që reflektojnë më mirë tipologjinë dhe objektivat konkrete të këtij lloji programi. Një fokus i tillë do të mundësonte vlerësime më të sakta, ndërhyrje më efektive dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij formati studimi.
Konkluzione	<i>Në përfundim, vlerësohet se Kolegji Universitar "LOGOS" ka ngritur dhe funksionalizuar strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore institucionale. Institucioni ka hartuar politika përkatëse, ka vendosur procedura të qarta dhe ka në funksion një sistem të brendshëm të mirëstrukturuar, i cili mbështetet në përfshirjen e aktorëve të ndryshëm, përfshirë edhe ekspertë të jashtëm, në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i> <i>Programi profesional i studimit në Agrobiznes ka kaluar procesin e akreditimit periodik dhe përfiton nga qasja institucionale e unifikuar për sigurimin e cilësisë. Megjithatë, evidencat e analizuara tregojnë se kjo qasje e përgjithshme nuk reflekton plotësisht natyrën specifike të programit profesional, i cili karakterizohet nga një kohëzgjatje më e shkurtër, profil i</i>

	ndryshëm studentësh dhe fokus më praktik. Pavarësisht këtyre kufizimeve, diskutimet me stafin përgjegjës për sigurimin e cilësisë konfirmojnë se brenda institucionit ekziston një procedurë funksionale dhe e konsoliduar. Rekomandohet që institucioni të zhvillojë instrumente të dedikuara për programet profesionale, të përshtatura me tipologjinë dhe qëllimet e tyre specifike, duke kaluar nga instrumente standardë në forma më cilësore e interaktive të vlerësimit, si grupet e fokusit, në mënyrë që të forcojë më tej lidhjen mes strukturave të cilësisë dhe nevojave reale të këtyre programeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore" është i organizuar në lëndë dhe module në përputhje me legjislacionin vendas si dhe Sistemin Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Shtojca nr 3: Rregullore e Programit të Studimit me karakter profesional ne "Agrobiznes me Profile", Shtojca 1.pdf: Misioni i programit të studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore") dhe vizita në institucion, rezulton se programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module duke respektuar shpërndarjen e krediteve sipas standartit të Vendimit Nr. 185, datë 25.3.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, "Për elemente të programeve

	të studimit të ofruara nga institucione të arsimit të lartë”, të ndryshuar. Organizimi i modulit është konceptuar në përputhje me elementët e VKM 41, organizimi i mësimit realizohet në 20-25 orë mësimore, 50 minutëshe me pushime 5 minutësh në mes. Panvarësisht kësaj, vihet re se në strukturën e programit është përfshirë Lënda: “Praktikë mësimorë” e kategorizuar si lëndë plotësuese (D). Përfshirja e kësaj lënde nuk është në përputhje me kategorizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke ndryshuar strukturën e moduleve dhe lëndëve të tjera në program.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Konceptimi i programit të studimit në të dy profilet e tij ofron një program me objektiv dhënien e njohurive që synojnë aftësimin teorik dhe praktik të studentit. Nga konsultimi i planit mësimor vihet re se më shumë se gjysma e lëndëve sigurojnë njohuri në njohje të mirë të teorive dhe parimeve akademike të kombinuara me kompetenca praktike. Konceptimi i strukturës së lëndëve është i ndarë në leksione, ushtrime dhe praktika në terren që mundësojnë fitimin e kompetencave për t’u orientuar në zgjidhjen e problematikave të ndryshme me karakter praktik. Pavarësisht strukturës së lëndëve, vihet re një shmangie në aftësitë dhe kompetencat e përparuara praktike, pasi lëndet e programit të studimit i përkasin një niveli apo cikli më të lartë studimi. Gjithashtu, edhe përmbajtja e lëndëve ka nevojë për përshtatje me realitetin e bujqësisë shqiptare.
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Programi i studimit 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me dy profile ka përcaktuar objektiva të qartë në lidhje përgatitjen e specialistëve të kualifikuar dhe të aftë respektivisht si për profilin “Marketing i Produktit Bujqësor”, ashtu edhe për atë “Menaxhimit të Fermës Bujqësore”, për të tregtuar produkte agroushqimore sipas standarteve europiane, për të zhvilluar e aplikuar praktika bashkëkohore dhe vlerësuar format e metodat më efikase të marketingut në fushën e agrobiznesit. Objektivi kryesor i këtyre programeve është që mbajtësi i tyre të zotërojë njohuri bazë teorike dhe praktike në profilin e marketimit të produkteve bujqësore, njohuri në përdorimin e programeve kompjuterike dhe të gjuhëve të huaja dhe ka aftësi të nevojshme organizative të punojë në grup dhe të orientohet në ambientet e punës. Si edhe në menaxhimin e fermës bujqësore dhe proceseve agropërpunuese. Në fokusin e tij të plotë, ky program studimi inkurajon tek studentët mendimin kritik dhe kreativ si dhe i ekspozon ata drejt

	çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e marketimit të produkteve bujqësore. Studenti fiton aftësi të komunikimit dhe të zgjidhjes së problemeve, të cilat janë tepër të rëndësishme e të nevojshme në bashkëveprimin me klientët, punonjësit dhe grupet e tjera të interesit (<i>Shtojca nr 14; Diploma dhe Diploma suplement; Shtojca nr 3: Rregullore e programit të studimit</i>).
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Mbështetur në raportimin e dokumenteve të konsultuara, programi i studimit ka të strukturuar planin e ngarkesës mësimorë në kredite për të gjitha lëndët. Informacioni është i detajuar në kategorizim të lëndëve, ngarkesa në kredite sipas veprimtarive mësimorë, ngarkesë mësimorë në orë fizike në auditor, orë studimi individuale dhe orë totale. Nga konsultimi i shtojcës përkatëse konstatohet se nuk duhet përfshirë në program lënda “Praktikë Mësimore” e vlerësuar me 6 kredite e shkëputur nga modulet dhe praktika profesionale (<i>Shtojca nr 2: Dosja e programit të studimit</i>).
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Në Kolegjin Universitar “Logos” pranimi i studentëve në institucion realizohen në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Theksojmë se, nga dokumentat dhe shtojcat e dorëzuara nga institucioni, nuk jepet qartë pranimi i studentëve sipas statusit të veçantë.
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, edhe pse raporti i vlerësimit të brendshëm nuk referon dokumentin e duhur, vihet re se programi i studimit me karakter profesional në Agrobiznes ofrohet në të njëjtën fushë me 2 drejtime: “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, plotëson kriterin pasi ka një ngjashmëri në nivelin 70% (12 module kanë të njëjtin emërtim dhe ngjashmëri në programin e parashikuar në syllabus, nga 17 module përveç praktikës mësimore profesionale dhe provimit final) (<i>Shtojca nr 14: Diplomat dhe Diplomat Suplement</i>).
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet	Nga vlerësimi raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacionit të referuar për procesin e kodifikimit të lëndëve rezulton se ato janë kategorizuar sipas kategorive A, B, C, D, E në lëndë bazë, karakterizuese, plotësuese dhe shoqëruese së bashku me kreditet përkatëse. Megjithatë nuk paraqitet një dokument argumentues i mënyrës sesi është gjykuar për

kodifikimi i lëndëve të programit.	realizimin e këtij procesi, siç referohet në raportin e vlerësimit të brendshëm.			
Konkluzione	Në përfundim, në strukturën e programit është përfshirë Lënda: "Praktikë mësimore" e kategorizuar si lëndë plotësuese (D), e cila nuk është në përputhje me kategorizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke ndryshuar strukturën e moduleve dhe lëndëve të tjera në program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore" realizohet nën përgjegjësinë e Fakultetit Ekonomik (FE). Ky Fakultet ka në përbërje të tij tri departamente: Departamenti i Financë - Kontabilitet; Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Agrobiznesit. Nga dokumenti referues i organogramës së paraqitur rezulton se plotësohen detyrimet e përcaktuara në legjislacion në fuqi. Prania e një Departamenti Agrobiznesi të konceptuar me dy grupe mësimore-kërkimore shkencore si ai i Marketingut dhe ai i Menaxhimit, ndihmon në profilizimin e mbështetjen e këtij programi profesional. (Shtojca nr 9: Struktura organizative e IAL dhe programeve Kolegji Universitar LOGOS).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga vlerësimi i raportit të vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion rezulton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit si Departamenti i Agrobiznesit ka angazhuar staf të dedikuar për ecurinë e aktiviteteve me karakter akademik në këtë program, por nuk rezulton të ketë anëtar - staf ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore. Departamenti është i përbërë nga 2 doktorë dhe 3 staf me master shkencash dhe një profesor i asociuar si staf me kontratë, në përputhje me specifikimet e marrëveshjes Prot. 6752, dt. 01.07.2019. Kriteri i stafit minimal në departament është plotësuar edhe për vitin akademik 2023-2024, ashtu edhe për vitin akademik 2022-2023, vit gjatë të cilit numri i stafit ka qenë 5 PAE (2 Dr dhe 3 MSc) dhe 2 PAK (1 Prof. Asoc. Dr. dhe 1 Dr.). (Shtojca nr.28

	Marrëveshje MAS me KU "Logos" për reduktimin e numrit të personelit akademik.pdf); (5. Tabelat akreditimi Agrobiznesi 2024.pdf). Në përbërjen e stafit akademik të programit me karakter profesional nuk është angazhuar asnjë anëtar stafi ndihmës akademik. Dokumenti i referuar në raport nuk i përgjigjet përmbushjes së kriterit sipas legjislacionit në fuqi (Shtojca, Tabela nr 6: Stafi akademik i programit).			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore – Fakulteti Ekonomik me vendim të Dekanit mbi Caktimin e koordinatorëve të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti Ekonomik, rezulton se ka miratuar koordinatorin e programit të studimit me karakter profesional 2-vjçar në Agrobiznes me profile. Pas vlerësimit të raportit rezulton se ky kordinator është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit për ndryshimet e propozuara në planin mësimor të programit të studimit, informon titullarin ëprkatës për ecurinë dhe zbatimin e programit të studimit dhe praktikave mësimore, komunikon me njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me problematikat e ndryshme, mbledhjen e të dhënave në lidhje me praktikat profesionale, zhvillimi i raporteve dhe analizave në lidhje me pyetsorët e ndryshëm të studentëve dhe stafit, koordinimit të aktiviteteve me karakter kërkimor - shkencor, bashkëpunimi me njësinë e Karrierës dhe Alumnit.			
Konkluzione	Dokumenti mbi përbërjen e stafit të programit të studimit, nuk paraqet praninë e një stafi ndihmës akademik. Ndjekja e praktikave mësimore dhe profesionale tregohet se është përgjegjësi e një anëtari stafi akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe	Njësia përgjegjëse për Programin e Studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore" informohet dhe disponon informacionin në lidhje me organizmin, strukturën dhe përmbytjen e programit të studimit përmes depozitimit të programit të lëndëve të ndarë në semestra,

përmbajtjen e programit të studimit.	ngarkesës mësimore në auditor, orët për përgatitjen e studentit, totalit të orëve, praktikës mësimore dhe profesionale. Informacioni i detajuar në lidhje me organizimin, kategorizimin kordinatorin e lëndës pasqyrohen përmes përmbatjes së syllabusit për secilin modul. Informacioni është i detajuar i plotë dhe analitik në lidhje me funksionimin e programit për të dy profilet e programit.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit profesional 2-vjeçar në Agrobiznes nuk reflekton në formën e një dokumenti të veçantë specifik me emërtimin “Plan mësimor”, por për të vlerësuar informacionin e nevojshëm të planit mësimor mund të konsultohen (<i>Shtojca 5. Tabelat akreditimi Agrobiznesi 2024</i>), si dhe dokumenta të tjerë: diploma dhe diploma suplement, në të cilin dalin në pah në mënyrë të detajuar me informacionin e nevojshëm rreth shpërndarjes së lëndëve në semestra, praktikës profesionale dhe provimit final. Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive ka respektuar kategorizimin e lëndëve në lëndë bazë (A) (15%), lëndë karakterizuese (B) (50%), lëndë ndërdisiplinore/integeruese (C) (15%), lëndë plotësuese (D) (15%), Detyrime përmbyllëse (E) (5%). Po ashtu informacioni plotësohet me numrin e krediteve dhe ngarkesat specifike në auditorë dhe jashtë auditorit. Informacioni është i plotë, i detajuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kurikula e programit të studimit ruan formalisht organizimin e saj në Kredite dhe module të cilat plotësojnë kritret e VKM 41, të ndryshuar (10-15% të krediteve për Lëndë Bazë (Kategoria A), 45-55% për Lëndë Karakterizuese (Kategoria B), 5-15% Lëndë Ndërdisiplinore (Kategoria C), 10-15% Lëndë Plotësuese (Kategoria D), dhe 3-5% Detyrime Përmbyllëse (Kategoria E). Analiza e moduleve tregon se lëndët profilizuese të programit të studimit nuk janë të paraqitura vetëm në kategorinë C- Lëndë ndërdisiplinore apo integruse por edhe kategorinë B- Lëndë karakterizuese. Ky ndryshim modulesh në 2 module ose 12 kredite të cilat duhet të ishin integruar në kategorinë C janë integruar në kategorinë B. Në këtë rast niveli i profilizimit është më i lartë se sa është parashikuar nga legjislacioni në fuqi duke rënë ndesh me VKM 41, e ndryshuar. Duhet theksuar gjithashtu se disa prej moduleve të cilat janë të shprehura në VKM 41, e ndryshuar se duhet të jenë pjesë e Kategorisë C siç është rasti i Informatikës, është integruar në kategorinë B në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në kategorinë C të kurikulës figuron moduli “Praktika mësimore” si një modul më vete dhe moduli “Praktika profesionale” si një modul më vete. Praktika mësimore është



	pjesë e programit mësimor të secilit prej moduleve dhe organizohet si pjesë e aktiviteteve të mësimnxënies së modulit. Kështu që moduli “Praktika mësimore” nuk ka arsye të jetë si modul më vete. (5. Tabelat akreditmi Agrobiznesi 2024.pdf)
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në Agrobiznes me profile në “Marketing i Produktit Ushqimor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” ka qartësisht të detajuar informacionin e nevojshëm për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit. Ky informacion bëhet i aksesueshëm përmes rregullores së studimit të programit, rregullores së Departamentit. Mbështetur në modelin e dokumentit referues (Shtojca nr 30: Vendim për kriteret e pranimi në programet e studimit që ofron Kolegji Universitar Logos) vihet re se procesi i përcaktimit të kuotave, kriterëve të pranimi dhe përzgjedhjes kalojnë një proces miratimi nga departamenti si njësi propozuese deri në rektorat përmes njësisë kryesore. Këto kriterë miratohen nga senati akademik i institucionit dhe i përcillen ministrisë për miratim. I gjithë ky proces zhvillohet edhe me informimin përmes zyrave të sektretarisë së Kolegjit. (Shtojca nr 18: Politika e pranimi të studentëve I)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Pas shqyrtimit të dokumentit referues (Shtojca nr 2: Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjithë elementët e nevojshëm) vihet re Programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në Agrobiznes me profile në “Marketing i Produktit Ushqimor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” ka të përcaktuar programin e lëndës në syllabuse. Syllabuset janë të plotësuar me të gjithë përvaktimeve që imponon VKM nr. 41, dt. 24.01.2018. Syllabuset përmbajnë informacion në lidhje me emrin e lëndës, emrin e koordinatorit të lëndës, numrin e krediteve (ECTS), numrin e orëve mësimore të ndarë në leksione dhe seminare, kategorizimin e lëndës, llojin e lëndës në program, semestrin ku zhvillohet ajo, disiplinën e formimit, mënyrën e vlerësimit, objektivat dhe qëllimet e saj, kalendarin mësimor dhe literaturën e rekomanduar. Informacioni është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Po ashtu ai jep informacion të plotë në lidhje me përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e organizimit të saj, kompetencat përmes së cilës student pritet të fitojë nga lënda, si dhe mënyra e kontrollit të dijes duke përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e studentit. Duke konsideruar faktin që ky program është një program profesional syllabuset janë ndërtuar në frymën e ekuilibrit

	praktik dhe teorik me vlerësimin 50:50 (Shtojca nr 2: Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjithë elementët e nevojshëm)
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	Programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në Agrobiznes me profile në “Marketing i Produktit Ushqimor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” sa i takon përmbajtjes së programit të studimit ka bërë përmirësim të vazhdueshëm duke përshtatur informacioni që ju jepet studentëve me të dhënat dhe arritjet e fundit të zhvillimit të tregut të produkteve bujqësore dhe aktivitetit bujqësor. Këto përmirësime reflektohen në rifreskimin e syllabuseve që miratohen nga drejtuesit e grupeve mësimore-kërkimore në formë digjitale dhe të printuar. Si rezultat i procesit të mëparshëm të akreditimit, ky program veçanërisht në profilin “Menaxhim i Fermës Bujqësore” ka përmirësuar dhe profilizuar më mirë njohuritë duke përfshirë në përmbajtje të programit lëndë të reja me karakter praktik dhe profesional për t’ju përgjigjur objektivave dhe qëllimeve të programit si psh., modulet e prodhimit bimor. Po ashtu programi i “Marketingu i Produktit Bujqësor” ka përmirësuar programin me lëndë me karakter praktik si plani dhe fushata marketing, e-marketingu. Por kjo është totalisht e pamjaftueshme duke pasur parasysh se disa Syllabuse kanë literaturë shoqëruese e cila daton në mesin e viteve 1980 (Fitotekni, apo Bazat e Prodhimit Bimor). Studentëve i jepen njohuri për kultivimin e kulturave bujqësore të cilat nuk kultivohen më në Shqipëri që prej vitit 1989 (orizi, pambuku, etj.) duke e shkëputur totalisht informacionin nga realiteti i bujqësisë shqiptare. Në përfundim duhet të theksojmë se procesi i përditësimit të programit të studimit ndodh vetëm me disa module por nuk ofron sigurinë për një përditësim të vazhdueshëm e cilësor. (Shtojca nr 2: Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm)
Konkluzione	Njësia përgjegjëse për Programin e Studimit Profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” ka treguar se zotëron informacion të detajuar dhe të qartë për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, të pasqyruar plotësisht në syllabusët e secilit modul. Programi ka një ndarje të mirë të krediteve sipas kategorive të parashikuara, por ka një shmangie nga kërkesat ligjore lidhur me kategorizimin e disa moduleve, sidomos në lidhje me modulët ndërdisiplinorë dhe karakterizues, duke tejkaluar nivelin e profilizimit të parashikuar nga VKM-ja nr. 41.

	<i>Megjithëse programi ka bërë përmirësime në përditësimin e syllabusëve dhe përshtatjen me kërkesat e tregut, veçanërisht duke futur module me karakter praktik dhe inovativ në të dy profilet, mbeten ende probleme serioze në lidhje me përdorimin e literaturës së vjetëruar dhe mungesën e lidhjes me realitetin aktual të bujqësisë në Shqipëri. Për të garantuar një cilësi të qëndrueshme dhe përditësim të vazhdueshëm, është e domosdoshme që të rishikohet dhe rifreskohet vazhdimisht literatura dhe përmbajtja e moduleve në mënyrë që ato të jenë plotësisht të përshtatshme për tregun aktual dhe nevojat reale të sektorit të agrobiznesit në vend.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në Agrobiznes me profile në “Marketing i Produktit Ushqimor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” është konceptuar për krijimin e dy profileve të profesionistëve respektivisht me kompetenca në njohjen e parimeve të menaxhimit të aktivitetit të femërs bujqësore dhe aktiviteteve të saj dhe atë të marketingut të produktit bujqësor. Nisur nga kjo premisë programi është konceptuar të ketë në përmbajtje të tij: Profili “Menaxhim i Produktit Bujqësor”: Baza të Ekonomisë, Ekonomi bujqësore, Ekstension Bujqësor, Menaxhim i Agrobiznesit, Politika të Menaxhimit të Agrobiznesit, Baza të Kontabilitetit, Sipërmarrje dhe Drejtimi Biznesit të Vogël, Baza Marketingu, Plan dhe Fushatë Marketingu, Teknik të shitjes së produktit Bujqësor, E-marketing, Informatikë e Zbatuar, Mbledhje e përpunim të dhënash, Komunik në Biznes, E drejtë Biznesi, Gjuhë e huaj Anglisht dhe Greqisht, Praktikë profesionale. Duke analizuar grupimin e lëndëve të mësipërme shihet se qëllimi i ndërtimit të këtij programi është krijimi i njohurive bazë të ekonomisë dhe ekonomisë bujqësore për të dhënë

	njohuri rreth karakteristikave dhe veçorive të biznesit bujqësor, mënyrës si realizohet dhe funksionon këshillimi në fushën e bujqësisë. Po ashtu jepen njohuri të përgjithshme në lidhje me parimet e menaxhimit të agrobiznesit dhe biznesit të vogël. Për të qëndruar në specifikat e programit, ai përmban një numër lëndësh me lidhje të ngushtë me parimet dhe praktikën e marketingut të produktit bujqësor si bazat e marketingut, planifikimi dhe teknikat e shitjes duke ndërthurur dhe praktikën e reja si rezultat i zhvillimit të teknologjisë. Gjithashtu, studenti aftësohet me njohuri integruese në përdorimin e informacionit dhe informatizimit, njohuri të se drejtës dhe komunikimit dhe atë të gjuhëve të huaja. Profili “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” përmban në 70% të tij lëndët e profilit të Marketingut të produktit bujqësor duke u plotësuar me njohuri të specifikës së fermës bujqësore si: Menaxhimi i burimeve Njerëzore, Fitoteknia, Prodhimi bimorë, Drejtimi i fermës, Menaxhimi i teknikës bujqësore. Të dy profilet kanë në përmbajtje të tyre emërtime të lëndëve që i shërbejnë formimit të studentit që përfundon këtë program studimi. <i>(Shtojca nr 2: Dosja e programit të Studimit me të gjithë elementët e nevojshëm)</i> Nëse do të ndaleshim në përmbajtje të lëndëve të programit ka vend për përmirësime në lidhje me përshtatjen e njohurive për kornizën së cilës i përket ky program studimi duke përshtatur nivelin e temave dhe thellësisë së tyre më shumë në aspektin më praktik.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Organizimi i lëndëve në programin e studimit Agrobiznes me profil “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore” ka një shpërndarje të konceptuar drejt ndërmjet semestrave duke i vënë theksin krijimin e njohurive bazë në semestrin e parë me qëllim krijimin e njohurive ndihmëse për përvetësimin e njohurive më të specializuara në semestrin e dytë e veçanësisht në vitin e dytë. Konceptimi i ndarjes në marrjen e njohurive 50% njohuri teorike dhe 50% aftësim praktik krijon premisë të mirë për të përputhur objektivat e programit me rezultatet e pritshme të tij. Ajo çfarë evidentohet si një mundësi për përmirësim është përfshirja e temave me karakter praktik në përmbajtjen e syllabuseve si puna në laboratore ose vizita në fermë, me baza të planifikuara sipas temave specifike, apo mbledhje e të dhënave në terren <i>(Shtojca nr 2: Dosja e programit të Studimit me të gjithë elementët e nevojshëm)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit	Programi i studimit ka ndërtuar një raport të balancuar midis

ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	formimit praktik dhe teorik të paraqitur në syllabus me raportin 50:50, po ashtu dhe ndërtimi i objektivave të programit në përputhje me profilin e tij. Nga një vështrim i syllabuseve vihet re se për më shumë se 50% e lëndëve të programit kemi organizim të aspektit praktik në detyra kursi dhe orë laboratorike. Nisur nga kjo shpërndarje programi nuk ka të pasqyruar qartë në çfarë forme apo për çfarë teme janë konceptuar orët laboratorike. Ky informacion mungon në përmbajtje të syllabuseve për lëndët të cilat kanë në përmbajtje të tyre të planifikuar orët laboratorike. <i>(Shtojca nr 2: Dosja e programit të Studimit me të gjithë elementët e nevojshëm)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit ka një ndarje të qartë të veprimtarive formuese dhe raporteve të formimit teorik dhe praktik në orë dhe ngarkesë nominale duke iu përshtatur arritjes së objektivave formuese të studentit. Por përmbajtja dhe detajimi i disa lëndëve ka potencial për përmirësim në pasqyrimin konkret të mënyrës sesi konceptet teorike zbatohen veçanërisht në orët laboratorike. Përmbajtja e njohurive dhe koncepteve të lëndëve është e tillë që i mundëson studentit adaptimin dhe transferimin në programe të tjera studimi apo mobilitete si dhe mundësinë për avancim të njohurive të tyre në këtë fushë profesionale. Programi zbaton një rregullore transferimi që mundëson lehtësimin e kësaj procedure dhe zbatimin sipas rregullave të këtij procesi e pasqyruar në rregulloren e përgjithshme të Njësisë Kryesore. Pavarësisht kësaj në këtë rregullore mungon specifikisht karakteristika e transferimit të studentit të këtij programi profesional. Po ashtu kjo mungon edhe në rregulloren e programit të studimit <i>(Shtojca nr. Dosja 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë, Rregullore e transferenceve)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhimin e Produktit Bujqësor” dhe “Meaxhimin e Fermës Bujqësore” përditëson përmes mbledhjes së opinionin të stafit përmbajtjen e moduleve. Për këtë vihet re një ndryshim në përfshirjen e disa lëndëve të reja të rekomanduar edhe nga procesi i mëparshëm i akreditimit që ka përmirësuar natyrë profesionale dhe praktike të këtij programi studimi. Syllabuset përmbajnë të gjithë elementët sipas kërkesave ligjore të VKM Nr. 41, dt 29.01.2019, duke përfshirë emërtimet e lëndës, kordinatorin, llojin dhe kategorizimin e saj, kohën e zhvillimit të saj, formën e sigurimit të dijeve dhe kontrollit të tyre, programin e lëndës, formën e

	kontrollit të dijeve, literaturën bazë dhe atë të ndihmëse. Mund të sugjerohej se në konceptimin e objektivave dhe rezultateve të paraqitej konkretisht mënyra sesi secila prej lëndëve kontribuon në formimin teorik dhe praktik të studentit, në ndërtimin dhe plotësimin e njohurive dhe orientimit që pritët prej një profesionisti të tillë.
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Natyra e programit profesional e vë theksin në rëndësinë e vlerësimit praktik të profesionistit në terren. Ky program përveç konceptimit për të përfshirë në programin e lëndës të orëve laboratorike por edhe marrëdhënies me punëdhënësit përmes praktikës profesionale. Institucioni ka një bazë të mirë marrëveshjes me biznese, institucione që mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Nga konsultimi i këtyre marrëveshjeve mund të vihet re se ato përfshijnë sektorë të turizmit dhe agroturizmit, shërbimit, tregtisë, teknologjisë së informacionit, sektorit financiar dhe kontabilitetit, agjenci me fokus zhvillimin bujqësor dhe blektoral. Lidhja e këtyre marrëveshjeve përbën një potencial për tu shfrytëzuar në aftësimin e studentëve të këtij programi 2-vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në "Menaxhim i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore" (Shtojca: Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me bizneset, Shtojca nr 2: Marrëveshjet e bashkëpunimit 1).
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Përmbajtja e programit siguron formim të mirë teorik dhe praktik me dije, aftësi dhe kompetenca me mundësi për tu orientuar në tregun e punës. Njohuritë e tyre janë të qëndrueshme dhe të ndara në tre drejtime kryesore si ajo e njohurive bazë ekonomike dhe sistemit ekonomik, njohuri përmbajtësore në lidhje me profilet respektive si ajo e marketimit të produkteve bujqësore apo menaxhimit të ekonomik bujqësore, fermave dhe agrobizneseve po ashtu edhe aftësimi me njohuri integruese si informatizimi, njohuri mbi legjislacionin dhe komunikimin dhe gjuhët e huaja (Shtojca nr 2: Dosja e programit të Studimit me të gjithë elementët e nevojshëm)
Konkluzione	Nëse do të ndaleshim në përmbajtje të lëndëve të programit mund të kishte vend për disa përmirësime në lidhje me përshtatjen e njohurive për kornizën së cilës i përket ky program studimi duke përshtatur nivelin e temave dhe thellësisë së tyre në aspektin më praktik, jo vetëm teorik. Gjithashtu, për studentët e programit të studimit mungon pjesa/neni i transferimit të studentit edhe në rregulloren e programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës merr rëndësi për suksesin dhe qëndrueshmërinë e programit. Pas vlerësimit të dokumentit referues forma e përzgjedhur për tërheqjen e opinioneve dhe mendimeve realizohet kryesisht përmes stafit akademik dhe drejtuesit të departamentit. Duket se nuk ka patur ndonjë nismë me qëllim të dedikuar marrjes së mendimit të aktorëve të tregut, institucioneve partnere, studentëve të diplomuar. Në praktikën e institucionit janë përfshirë aktivitete me natyrë të ndryshme nga të cilat mund të pasuroheshin në mënyrë të dedikuar rezultatet e bashkëpunimit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit 2- vjeçar profesional në Agrobiznes me profile në "Menaxhimin e Produktit Bujqësor" dhe "Meaxhimin e Fermës Bujqësore" inkurajon marrjen e opinionit të studentëve. Kjo realizohet kryesisht përmes pyetsorit të vlerësimit të lektorit apo sugjerimeve që studentëve depozitojnë për përmirësimin e syllabuseve. Po ashtu në respektim të funksionimit të organeve vendimarrëse, funksionon Këshilli Studentor përmes Statutit të Këshillit Studentor që krijon hapësirë të mjaftueshme për dhënien e opinionit dhe mendimeve (<i>Shtojca nr 26: Pyetsor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, Shtojca nr 4: Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit, Shtojca nr 100: Statuti i Këshillit Studentor</i>)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani,	Zhvillimi i programit të studimit monitorohet nga Departamenti i Agrobiznesit, opinioni i stafit të të cilit është burimi kryesor i vjeljes së informacionit për përmirësimin dhe përditësimin e tij, kryesisht përmes përmirësimit të përmbajtjes së syllabuseve. Në vijimësi nuk janë realizuar takime të dedikuara me qëllim angazhimit të aktorëve të tretë në përmirësimin e programit. Realizimi i studimit të tregut është instrumenti i

rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	vetëm për plotësimin me informacion rreth këtij programi si edhe shkëmbimet që mund të vijnë nga organizimi i orëve të hapura me lektorë dhe personalitete të ftuara.			
Konkluzione	<i>Përmirësimi i përmbatjes së programit të studimit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës për tërheqjen e opinioneve dhe mendimeve realizohet kryesisht përmes stafit akademik dhe drejtuesit të departamentit, duket mos patur ndonjë nismë me qëllim të dedikuar marrjes së mendimit të aktorëve të tregut,</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Kolegji Universitar “Logos” ka përfshirë një gamë të plotë formash të mësimdhënies dhe të të nxënit, të cilat përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi/ese, praktika profesionale dhe klinike, si dhe leksione të hapura, të pasqyruara qartë në planet mësimore dhe syllabuset përkatëse. Vlen të theksohet si një praktikë pozitive përdorimi i platformës www.edupage.com, e cila mundëson komunikim të vazhdueshëm dhe në kohë reale ndërmjet studentëve dhe stafit akademik. Jemi të vetëdijshëm se numri i kufizuar i studentëve mund të paraqesë vështirësi në organizimin e leksioneve të hapura. Megjithatë, duke qenë se bëhet fjalë për një program studimi me theks praktik, rekomandohet që këto leksione të plotësohen ose zëvendësohen me vizita studimore në ferma bujqësore, njësi grumbullimi apo pika përpunimi, të cilat do të përbënin një përvojë të vlefshme dhe stimuluese për studentët. Lista e mësimëve të hapura i drejtohet programeve të studimit të tjera dhe jo programit të studimit në vlerësim. (Udhëzues ne nivel

	<i>insitucional, metoda inovative te mesimdhenies.pdf; Shtojce nr 23. Aktivitetet e FE 1.pdf).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i Kolegji Universitar “Logos” vijon të përdorë platformat Microsoft Teams dhe EduPage si mjete alternative të mësimdhënies dhe komunikimit me studentët. Këto platformat lehtësojnë aksesin në materiale mësimore, zhvillimin e mësimi online dhe mbështesin ndërveprimin në kohë reale, duke përmbyshur në një masë të konsiderueshme nevojat e studentëve për fleksibilitet dhe përfshirje teknologjike në procesin mësimor. Megjithatë, duke qenë se programi i studimit në Agrobiznes ka një komponent të theksuar praktik, është e domosdoshme që përdorimi i teknologjisë të shoqërohet dhe bashkërendohet me aktivitete praktike në terren. Institucioni ka theksuar rëndësinë e vizitave në biznese bujqësore dhe agropërpunuese si pjesë e formimit profesional të studentëve. Sidoqoftë, gjatë procesit të vlerësimit nuk na është vënë në dispozicion një listë e strukturuar apo dokumentacion mbi frekuencën, temat, dhe objektivat e këtyre vizitave studimore. Rekomandohet që institucioni të formalizojë dhe të dokumentojë këto aktivitete praktike në mënyrë që ato të mund të monitorohen, vlerësohen dhe të kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve, në përputhje me objektivat e programit të studimit. (Udhëzues ne nivel insitucional, metoda inovative te mesimdhenies.pdf).
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, vlerësohet pozitivisht fakti që stafi akademik i programit ka mundësi të shkëmbejë eksperiencë me kolegë nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, me të cilat KU “Logos” ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me institucione me profil të ngjashëm, si Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, përfaqëson një mundësi të vlefshme për ndarjen e praktikave të mira dhe për përfitimin nga përvoja e këtyre institucioneve me traditë në fushën e bujqësisë dhe agrobiznesit. Gjithashtu, institucioni ka deklaruar përfshirjen e tij në programin Erasmus+, përmes të cilit janë krijuar lidhje me disa universitete të huaja partnere. Ky angazhim është në përputhje me përpjekjet për ndërkombëtarizimin e stafit dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor. Dy nga pedagoget e programit të studimit kanë marrë pjesë në periudha trajnimi dhe mësimdhënie

	në programin Erasmus+. (Shtojce nr 10. Mobilitete te stafit akademik ne kuader te Erasmus+ 1.pdf; Shtojce nr 23. Aktivitetet e FE 1.pdf).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Referuar dokumentacionit dhe CV-ve të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit në Agrobiznes, vlerësohet se pjesa më e madhe e stafit është e kualifikuar dhe kompetente në dhënien e njohurive, në përputhje me fushat e tyre të ekspertizës. Stafi aplikon një gamë metodash mësimore, përfshirë forma interaktive dhe gjithëpërfshirëse, të përshtatura sipas lëndës dhe profilit përkatës. Megjithatë, vërehet se për disa lëndë të profilit “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i produkteve bujqësore”, pjesa më e madhe e stafit ka formim akademik në fushën e menaxhimit apo ekonomisë, por jo domosdoshmërisht me specializim në bujqësi. Kjo krijon një mungesë të pjesshme të përmbajtjes teknike të lidhur ngushtë me realitetin e prodhimit bujqësor dhe menaxhimit specifik të fermave. Për të plotësuar këtë boshllëk, institucioni ka angazhuar pedagogë të ftuar me kontratë, të cilët zotërojnë përvojë të gjerë praktike dhe profesionale në fushën e bujqësisë. Kjo qasje është pozitive dhe ndihmon në ofrimin e njohurive teknike të nevojshme për studentët. Megjithatë, rekomandohet që të intensifikohet më tej përfshirja e përmbajtjeve dhe përvojave të lidhura ngushtësisht me menaxhimin konkret të fermave bujqësore dhe me veçoritë e marketingut të produkteve bujqësore. Kjo do të ndihmonte studentët të zhvillojnë kompetenca më të thelluara praktike dhe strategjike në këto dy drejtime kryesore të programit. (Tabelat përmbledhëse, Tabela 1.2)
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Një ndër mënyrat e reflektimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të formave dhe metodave të mësimdhënies është edhe përdorimi i instrumenteve të feedback-ut nga studentët, përfshirë pyetësorët e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër, në dokumentacionin e, konstatohet se institucioni e ka të parashikuar dhe zbaton këtë mekanizëm të mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve. Megjithatë, gjatë procesit të vlerësimit nuk na është vënë në dispozicion dokumentacion apo përshkrim i praktikës institucionale se si rezultatet e këtij pyetësori analizohen, adresohen dhe reflektohen në mënyrë konkrete në përmirësimin e procesit mësimor. Në këtë kontekst, mbetet e paqartë mënyra se si informacioni i mbledhur nga rubrika Komente/Sugjerime shitesë i kontribuon vendimmarrjes pedagogjike apo zhvillimit të

	stafit akademik. Duke marrë parasysh që Programi i Studimit me Karakter Profesional në Agrobiznes, me profilet "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhimi i Fermës Bujqësore", karakterizohet nga një numër i kufizuar studentësh, rekomandohet që institucioni të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të formave të tjera të mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve, përtej pyetësorëve standardë. Këto mund të përfshijnë intervista të drejtpërdrejta, diskutime të strukturuar, që mund të gjenerojnë reflektime më të thelluara dhe të përshtatura me kontekstin specifik të programit. (Shtojce nr 26.1. Formular vlerësimi nga studenti për cilësinë e mësimdhënies Teams 2021-2022 1.pdf; Politika për sigurimin e cilësisë.pdf)
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Vlerësohet pozitivisht fakti që institucioni është aktiv në krijimin e mundësive inovative për studentët, duke synuar rritjen e përfshirjes së tyre dhe zhvillimin e kompetencave të lidhura me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, ndonëse programi karakterizohet nga një numër relativisht i vogël studentësh, rekomandohet që të vijojë me një fokus të shtuar dhe të qëndrueshëm ndaj këtij programi, në mënyrë që të ruhet cilësia akademike dhe të maksimizohet impakti i ndërhyrjeve zhvillimore edhe në kontekste të vogla studimore.
Konkluzione	Institucioni garanton përmbushjen e standardit 3.1, që ka në qendër sigurimin e procesit të të nxënës dhe aftësimin profesional përmes metodave dhe praktikave bashkëkohore me studentin në qendër. Kolegji Universitar Logos ka integruar një shumëllojshmëri formash të mësimdhënies dhe të nxënies në programin e studimit në Agrobiznes, përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike, ese dhe detyra kursi, si dhe praktika profesionale. Vlerësohet pozitivisht përdorimi i platformave EduPage dhe Microsoft

	<i>Teams si instrumente për mësimdhënie të përzier (blended learning) dhe për ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me studentët.</i> <i>Stafi akademik është i kualifikuar në përgjithësi, por për disa lëndë kyçe të profilit të programit (si menaxhimi i fermës apo marketingu bujqësor), ka mungesë të ekspertizës specifike bujqësore.</i> <i>Përpjekjet për zhvillim të mëtejshëm profesional të stafit janë të dukshme përmes përfshirjes në bashkëpunime me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë mobilitete në kuadër të programit Erasmus+.</i> <i>Instrumentet për mbledhjen e feedback-ut nga studentët ekzistojnë, por nuk është dokumentuar qartë mënyra se si këto të dhëna përpunohen dhe përdoren për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</i> <i>Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve janë të pranishme dhe përfshirja e studentëve në forma të reja të mësimdhënies vlerësohet pozitivisht. Sidoqoftë, rekomandohet që fokusi ndaj programit të Agrobiznesit të jetë më i theksuar dhe i qëndrueshëm, për të ruajtur cilësinë në një kontekst me kapacitete të kufizuara studentore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit dhe të programit të studimit. Ato bëhen publike dhe njihen nga studentët nëpërmjet programeve të lëndëve (syllabuseve), të cilat u shpërndahen studentëve në fillim të çdo semestri dhe janë të aksesueshme në format elektronik në platformat institucionale. Kjo siguron transparencë dhe qartësi në lidhje me pritshmëritë akademike dhe mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë. Në Programin e Studimit me Karakter Profesional Agrobiznes, me profilet “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”, vlerësimi i studentëve organizohet përmes

	detyrave të kursit, projekteve dhe provimit përfundimtar, në përputhje me kërkesat dhe objektivat e çdo lënde. Sistemi i vlerësimit bazohet në vlerësimin me pikë, i cili përkthehet në notë përfundimtare sipas formulës së përcaktuar në rregullore. Një praktikë pozitive që duhet vlerësuar është ndarja e barabartë e peshës së vlerësimit: 50% e notës finale rrjedh nga provimi përfundimtar, ndërsa 50% nga vlerësimi i vazhduar gjatë semestrit, i cili përfshin detyrën e kursit dhe format e kontrollit të vazhdueshëm. Kjo qasje e balancuar e bën procesin e vlerësimit më gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të aftësive praktike dhe njohurive teorike në mënyrë të vazhdueshme, duke vendosur studentin në qendër të procesit mësimor dhe vlerësues. (Shtojca nr 2.1. Dosja e prog te studimit.pdf; Shtojce nr 3. Rregullore e programit te studimit 1.pdf)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Në përputhje me rregulloren institucionale dhe rregulloren specifike të programit të studimit, kriteret dhe format e vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale të studentëve përcaktohen qartë në syllabuset (programet e lëndëve) dhe u bëhen të ditura studentëve në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës/modulit. Kjo siguron transparencë dhe ndihmon në përafrimin e pritshmërive akademike me rezultatet e të nxënit. Kontrolli i dijeve organizohet në mënyrë të kombinuar përmes: testimave me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, punëve në grup, praktikave profesionale, si dhe provimit përfundimtar, i cili shënon mbylljen e procesit mësimor për çdo lëndë. Në Programin e Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në Agrobiznes, me profilet “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, vlerësimi kryhet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar një qasje dinamike ndaj progresit të studentit. Formula e vlerësimit është e strukturuar në mënyrë të balancuar: 50% e notës finale rrjedh nga provimi përfundimtar, 50% vjen nga vlerësimi i vazhduar (përmes detyrave të kursit dhe kontrollit periodik të dijeve gjatë semestrit). Ky sistem vlerësimi mbështet arritjen e rezultateve të të nxënit dhe ndihmon në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve, duke u fokusuar jo vetëm te produkti përfundimtar, por edhe te procesi i të nxënit gjatë gjithë vitit akademik. Shtojca nr 2.1. Dosja e prog te studimit.pdf; Shtojce nr 3.

Konkluzione	<i>Rregullore e programit te studimit 1.pdf).</i>			
	Kolegji Universitar "Logos" ka hartuar dhe zbaton rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, në përputhje me standardet institucionale dhe specifikat e programit të studimit. Këto procedura janë të publikuara në programet e lëndëve (syllabuse) dhe u bëhen të ditura studentëve në fillim të çdo semestri. Procesi i vlerësimit bazohet në një strukturë të balancuar dhe të shumëllojshme, duke kombinuar vlerësimin e vazhdueshëm me provimin përfundimtar, dhe duke përdorur forma të ndryshme si testime me shkrim e me gojë, detyra kursi, punë në grup dhe praktika profesionale. Kjo qasje siguron një proces vlerësimi gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt rezultateve të të nxënit, si në aspektin teorik ashtu edhe në zhvillimin e kompetencave praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe pasqyrohet në vlerësimin përfundimtar, sipas parashikimeve të bëra në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari përkatës.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Aktualisht, institucioni nuk ka në funksion sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të studentëve. Edhe pse për Programin e Studimit me Karakter Profesional në Agrobiznes, ku numri i studentëve është relativisht i kufizuar, mungesa e një sistemi të tillë nuk paraqet një shqetësim të menjëhershëm, përsëri mbetet e rëndësishme që institucioni të shqyrtojë mundësinë e integritetit të mjeteve dhe platformave elektronike të vlerësimit, në funksion të rritjes së transparencës, objektivitetit dhe ruajtjes

	së parimit të meritës në procesin e vlerësimit. Përdorimi i sistemeve elektronike mund të përbëjë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të procesit mësimor dhe vlerësues, si dhe një masë parandaluese kundër praktikave joetike, duke siguruar një standard të qëndrueshëm dhe të verifikueshëm në të gjithë institucionin. <i>Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf; Shtojca Dosja nr.1 - Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</i>.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Procesi i vlerësimit në Programin e Studimit me Karakter Profesional në Agrobiznes, me profilet "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhimi i Fermës Bujqësore", realizohet në përputhje me Rregulloren e KU "Logos", rregulloren e Fakultetit Ekonomik, si dhe rregulloren specifike të programit të studimit. Provimet organizohen nga komisione vlerësimi, të cilat përbëhen nga titullari i lëndës dhe një anëtar tjetër i përcaktuar nga departamenti përkatës, duke garantuar objektivitetin dhe standardizimin e procesit të vlerësimit. Megjithëse dokumentacioni evidenton përbërjen e komisioneve dhe zbatimin e rregulloreve përkatëse, nuk rezultojnë e dokumentuar në mënyrë të qartë praktika e ofrimit të komenteve ose këshillave individuale për studentët, që mund të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të performancës së tyre akademike. Rekomandohet që institucioni të zhvillojë mekanizma të formalizuar për feedback konstruktiv pas vlerësimeve, si pjesë integrale e procesit mësimor, në funksion të përmirësimit të nxënies dhe ndërtimit të një marrëdhënieje më të fortë student-pedagog. <i>(Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf; Shtojca Dosja nr.1 -Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni paraqet një sërë masash për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të plagjiaturës dhe kopjimit, të cilat zbatohen në praktikë nga personeli akademik dhe njësitë përgjegjëse. Këto masa përfshijnë sensibilizimin e studentëve për standardet etike akademike, verifikimin e origjinalitetit të punimeve dhe mbikëqyrjen rigoroze të procesit të provimeve. Megjithatë, do të ishte e udhës që këto masa të përfshihen dhe të formalizohen në Rregulloren e Programit të Studimit, në mënyrë që ky dokument të shërbejë si referenca ligjore e vetme dhe e detyrueshme për përcaktimin e procedurave dhe përgjegjësi të departamentit dhe stafit akademik lidhur me garantimin e integritetit akademik duke bërë kështu lidhjen organike midis rregulloreve të përgjithshme të KU "LOGOS"

	dhe asaj të programit të studimit (nenet 95-101). Përfshirja e qartë e këtyre dispozitave në rregullore do të forconte kuadrin rregullator dhe do të ndihmonte në rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve dhe stafit për pasojat e shkeljeve të normave etike në arsimin e lartë. (Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf; Shtojca Dosja nr.1 -Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në parimin e meritës dhe publikohen në kohë, në përputhje me dispozitat e rregulloreve të institucionit. Më konkretisht, nenet 97-100 të Rregullores së Kolegji Universitar "Logos" përcaktojnë mënyrën e organizimit të vlerësimit, afatet për shpalljen e rezultateve dhe detyrimin institucional për t'i komunikuar ato në mënyrë transparente dhe të qartë për studentët.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjithashtu, rregullorja u garanton studentëve të drejtën për të shqyrtuar dhe ankimuar vlerësimin e marrë, përmes një procesi të strukturuar dhe të rregulluar në nenet 100 dhe 101. Ky mekanizëm i ankimit i jep studentit mundësinë të kërkojë rishikim të vlerësimit në rast të pakënaqësisë së argumentuar, duke siguruar kështu besueshmëri, drejtësi dhe objektivitet në gjithë procesin e vlerësimit akademik.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Zbatimi i këtyre rregullave kontribuon në garantimin e një mjedisi akademik të bazuar në transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet, ku rezultatet pasqyrojnë realisht përpjekjet dhe arritjet individuale të studentëve. (Shtojce nr 3. Rregullore e programit të studimit 1.pdf; Shtojca Dosja nr.1 -Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf)
Konkluzione	Institucioni siguron një proces vlerësimi të drejtë, të bazuar në meritë dhe transparent, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe pasqyrohet në notën përfundimtare, sipas metodologjisë së parashikuar në syllabuset e lëndëve. Megjithëse KU "Logos" aktualisht nuk përdor sisteme elektronike të testimit, praktikat ekzistuese janë të strukturuar, dhe rekomandohet integrimi i mjeteve digjitale për të rritur transparencën dhe objektivitetin. Provimet zhvillohen në përputhje me rregulloret institucionale dhe të programit, përmes komisioneve vlerësuese të ngritura nga departamenti përkatës. Institucioni ka ndërmarrë masa për parandalimin e plagjiaturës

	dhe kopjimit, por theksohet nevoja për përfshirjen e këtyre masave në rregulloren e programit të studimit për të forcuar bazën ligjore. Gjithashtu, studentëve u garantohet e drejta për të ankimuar notën, përmes një procesi të formalizuar, duke siguruar respektim të standardeve të drejtësisë akademike dhe mundësinë për rishikim objektiv.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar informacionit të mbledhur nga takimet me studentët dhe stafin akademik, konstatohet se metodat mësimore të përdorura - si puna me raste studimore, detyrat e kursit dhe projektet në grup - shërbejnë për të aktivizuar studentët dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale. Kjo përbën një aspekt pozitiv të zbatimit të programit në praktikë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vëren se lëndët e përfshira në programin e studimit me karakter profesional në Agrobiznes nuk përfaqësojnë plotësisht një pasqyrim të nevojave aktuale të tregut të punës për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm profesional. Programi, në përmbajtje dhe mënyrë të strukturimit, i ngjan më tepër një cikli të parë universitar (Bachelor), sesa një diplome profesionale 2-vjeçare. Për më tepër, vërehet mungesa e njohurive themelore dhe aktuale, si p.sh., Prodhimin bujqësor në sera, Ekonomia blu, apo tema të tjera të lidhura ngushtë me realitetin e sotëm bujqësor dhe rural. Gjithashtu, një pjesë e syllabuseve mungojnë në dokumentacionin e dorëzuar, ndërsa disa module përmbajnë informacion të avancuar, që nuk përputhet me nivelin e studentëve të një programi profesional 2-vjeçar, duke rrezikuar mosrealizimin e objektivave praktike të programit. Rekomandohet një rishikim i thelluar i strukturës së programit të studimit, jo vetëm në terma të përmbajtjes së moduleve, por edhe në mënyrën e ofrimit të njohurive dhe kompetencave, në funksion të qëllimit formues të një diplome me karakter profesional.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Programi i studimit me karakter profesional në Agrobiznes, me profilet "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhimi i Fermës Bujqësore", synon të pajisë studentët me aftësi të

teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	përgjithshme dhe të veçanta në fusha të ndryshme që lidhen me profilin profesional, përfshirë aftësitë sociale, të komunikimit dhe të ndërveprimit. Megjithatë, nuk garantohet në mënyrë të plotë përfshirja sistematike dhe bashkëkohore e aftësive specifike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe teknologjive të reja të sektorit agro-ushqimor.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në kontekstin aktual të zhvillimeve në sektorin bujqësor, si menaxheri i fermës ashtu edhe specialisti i marketingut të produkteve bujqësore, duhet të jenë të pajisur me njohuri mbi teknologjitë moderne të prodhimit, ruajtjes, përpunimit dhe tregtimit të produkteve. Këto njohuri janë thelbësore për të siguruar gatishmërinë e studentëve për integrim në tregun e punës, i cili është gjithnjë e më shumë i varur nga zgjidhjet teknologjike dhe digjitale. Vërehet se literatura e përdorur në disa lëndë është e vjetruar dhe, në disa raste, tërësisht e papërshtatshme për realitetin shqiptar. Njohuritë e ofruara për kultura si pambuku apo orizi, të cilat nuk janë kultivuar në Shqipëri për më shumë se tre dekada, tregojnë për një mospërditësim të materialeve didaktike dhe një mospërputhje me kontekstin aktual ekonomik dhe bujqësor të vendit. Rekomandohet një përditësim i thelluar i përmbajtjes mësimore dhe i literaturës së referencës, në mënyrë që të pasqyrohen zhvillimet më të fundit teknologjike dhe praktikat bashkëkohore të sektorit bujqësor dhe agropërpunues, duke e bërë programin më të përshtatshëm dhe të vlefshëm për studentin dhe për tregun e punës. <i>(Shtojca nr 2.1. Dosja e prog te studimit.pdf)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se, pavarësisht se programi i studimit përfshin elementë të praktikës profesionale dhe ka parashikuar komponente bashkëpunimi me institucione të tjera, mësimdhënia nuk është realisht e ndërtuar mbi bazën e kompetencave. Lëndët e përfshira në program dhe ndërtimi i tyre nuk sigurojnë zhvillimin e aftësive praktike të zbatueshme në kontekstin e tregut të punës, duke rezultuar në një mospërputhje midis synimeve të një programi profesional dhe mënyrës së ofrimit të përmbajtjes mësimore. Në mungesë të një strukture të bazuar në kompetenca, studentët nuk përfitojnë në mënyrë të plotë nga laboratorët apo praktikat për të thelluar dhe aplikuar njohuritë teorike. Për më tepër, nuk evidentohet një ndërthurje efektive me institucionet bashkëpunuese për të mbështetur mobilitetin, ndonëse ky është një aspekt thelbësor për profilin profesional të programit. <i>(Shtojca nr 2.1. Dosja e prog te studimit.pdf)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik,	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik në zhvillimet

efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	e fundit shkencore dhe teknologjike është i kufizuar. Përditësimi i përmbajtjes mësimore, përfshirë programet e lëndëve (syllabuset), nuk reflekton rritjet që karakterizojnë sektorin bujqësor dhe agro-ushqimor sot. Gjithashtu, mungesa e orëve të hapura apo seminareve të strukturuar mbi zhvillimet bashkëkohore i heq programit një mundësi të vlefshme për të ofruar shtesë vlerë dhe për ta afruar më shumë me realitetin profesional. Në këtë drejtim, GVJ thekson se duhet të ekzistojë një lidhje më e fortë dhe sistematike midis programit të studimit dhe sektorit privat (bizneseve agro-ushqimore), në mënyrë që studentët të kenë akses në teknologji të reja, praktika bashkëkohore dhe mundësi reale punësimi pas përfundimit të studimeve. Edhe pse GVJ është e ndërgjegjshme për sfidën që paraqet numri shumë i ulët i studentëve (1 student në vitin e parë dhe 2 në të dytin), kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe dinamizmin e programit të studimit, duke e kufizuar ndjeshëm përvojën mësimore dhe ndërveprimin akademik.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit me karakter profesional në Agrobiznes nuk garanton në mënyrë të plotë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale dhe rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve. Përmbajtja e lëndëve dhe mënyra e ndërtimit të programit nuk janë të përshtatura me profilin e një diplome profesionale 2-vjeçare dhe nuk reflektojnë nevojat aktuale të tregut të punës. Mungesa e përfshirjes së teknologjive bashkëkohore, përmbajtjes së përditësuar dhe lidhjes efektive me sektorin privat ndikon negativisht në përgatitjen praktike të studentëve. GVJ rekomandon rishikimin e thelluar të programit në përmbajtje, metodologji dhe përputhje me standardet e arsimit profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Studimet në Programin e Studimit me Karakter Profesional në Agrobiznes, me profilet përkatëse, përmbyllen me një provim përfundimtar, siç është parashikuar në Rregulloren e Njësisë

realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Bazë dhe në dokumentacionin shoqërues të programit. Për të orientuar studentët në përgatitjen e këtij provimi, institucioni vë në dispozicion një databazë orientuese, e cila përmban përmbledhje pyetjesh të provimit të përgjithshëm. Megjithatë, rekomandohet që informacioni mbi procedurën e diplomimit dhe mënyrën e zhvillimit të provimit përfundimtar të integrohet në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Kjo do të siguronte një dokument unik referimi për studentët dhe stafin akademik, si dhe do të rriste transparencën, qartësinë dhe standardizimin e procesit të diplomimit në përputhje me objektivat e programit me karakter profesional. (Shtojca nr.33.10 - Njoftime per banken e pyetjeve per provim formimi.pdf)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Institucioni, përmes strukturave përgjegjëse dhe stafit akademik, ofron mbështetje për studentët në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse të programit, përmes informacioneve orientuese, udhëzimeve specifike dhe materialeve ndihmëse për përgatitjen e provimit përfundimtar. Në këtë kuadër, studentëve u vihet në dispozicion një databazë me pyetje orientuese, si dhe materialet për rishikim, të cilat ndihmojnë në përvetësimin e njohurive të nevojshme.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjithashtu, procedura e diplomimit është e detajuar në Rregulloren e përgjithshme të KU "Logos" (neni 113) në rregulloren e Fakultetit Ekonomik (neni 63), duke përfshirë mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të provimit përfundimtar. Megjithatë, nuk evidentohet përfshirja e këtij informacioni në rregulloren specifike të programit të studimit. Rekomandohet që udhëzimet, afatet dhe procedurat e diplomimit të integrohen në mënyrë të qartë dhe të strukturuar edhe në Rregulloren e Programit të Studimit, në mënyrë që studentët të kenë një dokument unik referimi dhe procesi i diplomimit të jetë më transparent, i standardizuar dhe i lehtë për t'u ndjekur nga të gjitha palët e përfshira. (Shtojca Dosja nr.1 -Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf; Shtojca Dosja nr.1-Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf; Shtojca nr.33.10 - Njoftime per banken e pyetjeve per provim formimi.pdf)
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve,	N.a

përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	N.a.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit përfundimtar, studenti vlerësohet me notë sipas një procedure të përcaktuar qartë në Rregulloren e përgjithshme të KU "Logos", e cila përshkruan mënyrën, kohën dhe afatet e vlerësimit, procesin e korrigjimit të provimit si dhe shpalljen e rezultateve. Kjo procedurë garanton transparencë dhe standardizim të procesit të vlerësimit për detyrimet përmbyllëse dhe kontribuon në ruajtjen e parimit të meritës dhe drejtësisë akademike. Megjithatë, rekomandohet që e njëjta procedurë të jetë e përfshirë dhe e dokumentuar në mënyrë të qartë edhe në Rregulloren e Programit të Studimit, si një referencë e drejtpërdrejtë për studentët dhe stafin akademik, duke siguruar një qasje të unifikuar dhe të aksesueshme në lidhje me procesin e vlerësimit final. <i>Shtojca Dosja nr.1 -Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf; Shtojca Dosja nr.1-Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf; Shtojca nr.33.10 - Njoftime per banken e pyetjeve per provim formimi.pdf).</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve në Programin e Studimit me Karakter Profesional në Agrobiznes, me profilet përkatëse, studenti pajiset me "Diplomë Profesionale" dhe "Shtojcën e Diplomës", të lëshuara sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Këto dokumente janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe garantojnë njohjen zyrtare të kualifikimit të fituar nga studenti. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të ndjekur, në të cilën pasqyrohen të gjitha modulet e zhvilluara, kreditet dhe përmbajtja e përgjithshme akademike, duke garantuar transparencë, qartësi dhe vlefshmëri të dokumentacionit të përfundimit të studimeve.

	Kjo praktikë është në përputhje me standardet e arsimit profesional dhe ndihmon në lehtësimin e integritetit të studentëve në tregun e punës apo në vijimin e mëtejshëm të studimeve. (Komunikimi ne Teams per diplomimin.pdf; Shtojce nr 14. Diplomat dhe suplementet e diplomave.pdf).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kolegji Universitar “Logos” ruan dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloren institucionale për arkivimin e dokumenteve. Dokumentacioni mbahet si në format fizik (hard copy), ashtu edhe në databazën digjitale të institucionit, duke garantuar ruajtjen, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave akademike të çdo studenti. Institucioni është në gjendje të paraqesë informacion zyrtar për studentin në çdo rast kur kërkohet, në përputhje me të drejtat e individit dhe kërkesat ligjore për akses në dokumente personale. Kjo praktikë siguron mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe funksionimin efikas të administratës akademike dhe mbarëvajtjen e ciklit të jetës studentore.			
Konkluzione	Kolegji Universitar “Logos” ndjek një procedurë të qartë për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të studentëve në Programin Profesional në Agrobiznes dhe garanton pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithëse procedurat e diplomimit dhe të vlerësimit janë të përshkruara në rregulloret institucionale dhe fakultare, mungesa e tyre në Rregulloren e Programit të Studimit kufizon qasjen e drejtpërdrejtë të studentëve në informacion të detajuar për këtë proces. Rekomandohet përmirësimi i koherencës dokumentare dhe integriteti i të gjithë elementëve përkatës të diplomimit brenda rregullores së programit, për të garantuar transparencë dhe orientim të qartë për studentin gjatë fazës përmbyllëse të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional	Institucioni, në dokumentet e tij strategjike dhe në Raportin e Vetëvlerësimit, shpreh angazhimin për të mbështetur zhvillimin

për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të përshtatura sipas fushës së studimit dhe karakterit të lëndëve/moduleve. Ky qëndrim është në përputhje me parimet moderne të arsimit të lartë dhe me nevojën për të përfshirë studentin në mënyrë aktive në procesin mësimor.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Megjithatë, kjo mbështetje nuk pasqyrohet qartë në përmbajtjen e syllabuseve të programit të studimit në Agrobiznes, ku metodat e mësimdhënies të përshkruara janë kryesisht tradicionale dhe nuk reflektojnë qasje të reja apo interaktive, të tilla si të mësuarit e bazuar në projekte, simulimet, punët praktike të integruara ose përdorimi i teknologjive digjitale për përfshirje më të gjerë të studentëve. Rekomandohet që përveç mbështetjes në nivel institucional, zhvillimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies të pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe sistematike në syllabuset e çdo lënde, për të siguruar koherencë ndërmjet qëllimeve të deklaruara dhe zbatimit në praktikë. <i>(Udhëzues ne nivel insitucional, metoda inovative te mesimdhënies.pdf)</i>
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni, nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë (KPGSC), ka ngritur struktura funksionale për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies. Këto struktura hartojnë raporte semestrale dhe vjetore, të cilat përfshihen në raportin institucional të miratuar nga Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, dhe më pas paraqiten në Ministrinë e Arsimit në përmbushje të detyrimeve ligjore të institucionit.
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sipas Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, këto raporte duhet të përmbajnë analizën e gjetjeve dhe të jenë të shoqëruara me masa konkrete për përmirësimin e aspekteve të identifikuara si problematike. Megjithatë, GVJ vëren se, ndonëse procesi i monitorimit dhe raportimit formal ekziston, analizat e realizuara nuk kanë çuar në përmirësime të prekshme në përmbajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies. Konkretisht, analiza e syllabuseve tregon se nuk ka pasur përmirësime të dukshme që të pasqyrojnë ndërhyrje të drejtpërdrejta nga vlerësimet e kryera, duke ngritur pikëpyetje mbi efektivitetin e ciklit të mbyllur të sigurimit të cilësisë. Rekomandohet që përfundimet e raporteve të monitorimit të përkthehen në masa konkrete për përmirësim, të ndjekura me një plan veprimi dhe afate të përcaktuara qartë, në mënyrë që të realizohet funksioni thelbësor i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë: përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së

	mësimdhënies. (Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucioni.pdf; Politika për sigurimin e cilësisë.pdf).			
Konkluzione	Institucioni ka ngritur struktura dhe ka hartuar dokumente politike që mbështesin garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, përfshirë edhe udhëzues për përdorimin e metodave inovative. Megjithatë, angazhimet institucionale nuk reflektohen në mënyrë të qartë në dokumentet bazë të programit, si syllabuset, ku mungon pasqyrimi i qasjeve bashkëkohore të mësimdhënies. Gjithashtu, procesi i monitorimit të cilësisë, ndonëse formal dhe i institucionalizuar, nuk ka prodhuar përmirësime të prekshme në përmbajtjen dhe metodologjinë e mësimdhënies. Rekomandohet forcimi i lidhjes mes analizave të brendshme të cilësisë dhe përmirësimeve konkrete në praktikën akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e	Personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit përfaqësohet nga 5 anëtarë me kohë të plotë, dy prej të cilëve mbajnë gradën shkencore Doktor i shkencave, 3 prej tyre janë Master i Shkencave. Programi ka gjithashtu anëtarë stafi të angazhuar si të ftuar me titullin Profesor i Asociuar apo gradën shkencore Doktor. Bazuar në kriteret ligjore personeli i angazhuar, pas

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	marrëveshjes së lidhur midis Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Kolegjit Universitar “Logos”, përmbush kriteret nominale ligjore. Pas konsultimeve me informacionin e CV-të e anëtarëve të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi rezulton se ata përmbushin nivelin e kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe mbulimin e lëndëve të programit. Në rastin e mbulimit të lëndëve, ka anëtar të stafit që kalojnë numrin maksimal të lëndëve të lejuara brenda një viti akademik. Në përgjithësi fusha kërkimore dhe eksperiencia e lektorëve të programit përputhet me natyrën e programit të studimit dhe veçoritë e tij. Procesi i vlerësimit të ngarkesës mësimore ndjek një proces transparent diskutimi me anëtarët e stafit të njësisë bazë në përputhje me fushën e kërkimit, performancën e stafit dhe ngarkesën në programet e tjera të fakultetit. Po ashtu stafi angazhohet me përgjegjësitë e detyrimet e tjera të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. <i>(Shtojca, tabela 4, 12, Ngarkesa Mësimore, Shtojca nr 27: CV e Stafit Akademik).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar (efektiv dhe me kontratë) plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Respektivisht përgjatë vitit akademik 2022-2023 janë angazhuar në Departamentin e Agrobiznesit 5 anëtarë personel akademik efektiv nga të cilët me gradën shkencore Doktor, janë 2 anëtarë dhe 3 të tjerë kanë titullin MSc. Sa i takon numrit të aëntarëve me kontratë janë angazhuar 5 anëtarë respektivisht njëri prej tyre me titullin Profesor i Asociuar dhe 4 prej tyre me gradën shkencore Doktor. Ky raport është ruajtur edhe për vitin akademik 2023-2024. Referuar ngarkesës mësimore të parashikuar si edhe duke konsideruar marrëveshjen e lidhur mes Kolegjit Universitar “Logos”, për reduktimin e numrit të personelit akademik nga 7 në 5, por duke respektuar mbulimin e ngarkesës prej më shumë 70% të saj nga stafi i brendshëm efektiv <i>(Tabela nr 4: Ngarkesa totale e personelit akademik sipas programit në një vit akademik; Tabelat nr: 2, 4, 6,7, 12).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me	Pas konsultimit të organogramës, dokumentave referuese mund të konstatohet se insitucioni garanton qëndrueshmëri të personelit. Personeli akademik efektiv por edhe me kontratë rezulton të jetë pa ndryshime përgjatë vitit akademik 2022-2023 dhe 2023-2024. Politikat e rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe me kontratë janë të përcaktuara mirë nga Zyra e Burimeve Njerëzore në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe bashkerendim me kriteret

sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	dhe kërkesat e njësisë bazë dhe asaj kryesore. Nga dokumentacioni i referuar rezulton se institucioni ka të plota dhe të përditësuara dokumentacionin e stafit si edhe kontratat e nënshkruara. Në këto kontrata parashikohet detyrimet dhe të drejtat e palëve të mirëpërcaktuara në të.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Kolegji Universitar “Logos” ka ndjekur procedura rekrutimi të personelit akademik duke respektuar aktet ligjore në fuqi si Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës dhe Statutin e tij. Procedurat në këtë institucion fillojnë me përcaktimin e nevojave për staf akademik nga njësia bazë si propozuese në funksion në nevojave të fillim vitit akademik dhe fillim semestri për personelin me kontratë. Pasi kalohet miratimi i Njësisë Kryesore, Dekani përcjell kërkesën në komisionet <i>ad-hoc</i> që ngrihen me këtë funksion. Në përputhje me dokumentat e referuara procesi fillon me shpalljen e vendit vakant, mbledhjen e kërkesave, që shqyrtohen nga zyra e burimeve njerëzore dhe organizimit të procedurave të konkurimit nepërmjet dosjes që kandidatët kanë paraqitur. Për klasifikimin e tyre përdoret sistemi i pikëzimit për kriteret e paracaktuara. Po ashtu realizohet intervista me kandidatët e cila përbën 40% të vlerësimit të kandidatëve. Më pas Zyra e Burimeve Njerëzore njofton kandidatët fitues. Më pas kryhet nënshkrimi i kontratës së punë me anekset përkatëse (<i>Shtojca nr 7: Politika dhe Procedura e burimeve Njerëzore në kolegjin Universitar “Logos”, Dosje nr 7: Kontrata individuale</i>)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni njeh dhe specifikon rëndësinë e personelit ndihmës akademik në lidhje me mbarëvatjen e procesit mësimor veçanërisht në lidhje me programin 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me dy profile në “Menaxhimin e Produktit Bujqësor” dhe “Meaxhimin e Fermës Bujqësore”. Megjithatë në organogramën e stafit të programit dhe as në kontratat e nënshkruara, edhe pse një model kontrate ekziston, nuk pasqyrohet. Për shkak të numrit të ulët të studentëve mbulimi i ngarkesës së stafit ndihmës akademik është mbuluar nga stafi akademik. (<i>Shtojca nr 2: Plani mësimor i programit të studimit me karakter profesional në Agrobiznes me profile</i>)
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e	Institucioni mbledh dhe ruan informacionin në lidhje me personelin akademik. Përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Arkivit dhe Protokollit ky informacion ruhet dhe përditësohet në lidhje me ndryshimet e mundshme. Po ashtu dokumentacioni dokumentohet dhe ruhet nga njësia përgjegjëse për organizimin e programit. Informacioni i vetëm që mungon

personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	është ai i personelit ndihmës akademik. <i>(Shtojca nr 7: Politika dhe Procedura e burimeve Njerëzore në kolegjin Universitar "Logos", Dosje nr 7: Kontrata individuale, Shtojca dosja nr 1: rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë që ofrojnë programin, rregullore Arkiv- Protokolli)</i>			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni, ka përcaktuar një anëtar të stafit akademik si staf akademik efektiv i ngarkuar me mbikëqyrjen e procesit të instruktimit, udhëheqjes, mbikëqyrjes së studentëve në praktikën profesionale dhe veprimtari si praktikant mësimor në pëputhje me natyrën e programit profesional. Sa i takon kualifikimit të këtij stafi mungon dokumentacioni përkatës për vlerësimin e përgatitjes dhe përshtatshmërisë së tij në këtë pozicion. <i>(Tabela 5: Tabela Akreditimi Agrobiznesi 2024; Shtojca nr 27: Cv- të e Stafit Akademik).</i>			
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni ka marrëveshje për kryerjen e praktikës profesionale në institucione të ndryshme duke përcaktuar detyrimet dhe të drejtat e palëve nga ky proces. Marrëveshjet e lidhura parashikojnë jo vetëm dhënien mundësi të studentëve të kryerjes së praktikës, por edhe përcaktimin e një personeli i ngarkuar me mbikëqyrjen në ambientin pritës i cili angazhohet me vlerësimin e detyrimeve të studentëve për realizimin e praktikës mësimore. Po ashtu në përfundim të praktikës profesionale ky person jep aprovimin dhe vlerësimin e tij të përgjithshëm në lidhje me ecurinë e praktikës profesionale. <i>(Shtojcë nr 31: Praktika mësimore, Formularë, Relacione, Shembull i plotësuar)</i>			
Konkluzione	<i>Në rastin e mbulimit të lëndëve, ka anëtar të stafit akademik që kalojnë numrin maksimal të lëndëve të lejuara brenda një viti akademik.</i> <i>Në organogramën e stafit të programit dhe as në kontratat e nënshkruara edhe pse një model kontrate ekziston, nuk pasqyrohet angazhimi i stafit ndihmës akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset ku zhvillohet mësimi për programin 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhimin e Produktit Bujqësor” dhe “Meaxhimin e Fermës Bujqësore” ndodhen në Kampusin nr. 1 të Kolegjit Universitar “Logos” në një sipërfaqe 5931 m². Godina është e pozicionuar në një vend të përshtatshëm, të aksesueshëm lehtësisht për studentët, me mjedise të mjaftueshme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme të procesit mësimor. Institucioni ka kapacitetet infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit duke vënë në dispozicion 10,4m² për çdo student me kapacitete teknike dhe fizike për çdo student. Referuar dokumentave të vënë në dispozicion godina ku kryehet aktiviteti mësimor plotëson kriteret në lidhje cilësinë e ndriçimit dhe ndotjes akustike, certifikuar nga specialistët përkatës. Po ashtu institucioni zotëron një kontratë me shoqëri konsulence dhe mjekun e institucionit për sigurinë, mbrojtjen në punë të studentëve <i>(Shtojca nr 46: Tabela e Godinave të Kampuseve; Shtojca nr 47: Inspektimi teknik i kampusit; Shtojca nr 48: Relacion mbi infrastrukturën; Shtojca nr 49: Leje Higjeno-Sanitare; Shtojca 50: Kontratë mbrojtje në punë; Shtojca nr 51: Kontratë me mjekun e institucionit; Shtojca nr 52: Plan evakuimi i kampusit; Shtojca nr 53: Procesverbal inspektik i kampusit; Shtojca nr 54: Analizë e treguesve fiziko kimik)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor si klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete të teknologjisë që garantojnë realizimin me cilësi të procesit mësimor në nivel teorik dhe praktik. Mjediset e leksioneve të dedikuara për programin 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes janë të pajisura me projektor, kompjutera, webcam dhe këto pajisje kanë të instaluar software si Microsoft Office dhe Linux me akses të plotë dhe të vazhdueshëm në internet. Procesi i mirëmbajtjes së laboratorëve pasurohet me pajisje të reja në mënyrë periodike sipas nevojave për të mos çënuar cilësinë e mësimdhënies. <i>(Shtojca nr 57: Foto të laboratorëve)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot,	Në përmbajtjen e programit të studimit 2- vjçar me karakter



atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhimin e Produktit Bujqësor” dhe “Meaxhimin e Fermës Bujqësore” ka mjaft module që do të kërkonin përdorimin e laboratorëve si të teknologjisë së informacionit ashtu edhe të analizave të ndryshme. Në dispozicion të këtij programi rezulton se institucioni ofron laboratorë të informatikës me kapacitet 20 kompjutera funksional të pajisur me programet e duhura në funksion të procesit mësimor. Biblioteka e kampusit është riorganizuar plotësisht duke zgjeruar sipërfaqen me 40 poste studimi dhe 18 poste të përdorimit të kompjuterave duke askësuar materiale të ndryshme në funksion të përgatitjes së studentëve dhe stafit akademik. (Shtojca nr 57: Foto të laboratorëve; Shtojca Dosja Tabela 16)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni Kolegji Universitar “Logos”, ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programi një laborator të informatikës të përshtatur me software të ndryshëm për zhvillimin e lëndëve përkatëse. Përdorimi i kompjuterave të bibliotekës ka mundësuar gjithashtu zgjerimin e mundësive për punë individuale të studentëve dhe stafit të programit (Shtojca nr 57: Foto të laboratorëve; Shtojca Dosja Tabela 16, Shtojca nr 25: Biblioteka)			
Konkluzione	Kolegji Universtiar “Logos”, vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit	Nga konsultimi syllabuseve rezulton se literatura bazë dhe e rekomanduar është e përshtatshme për krijimin e njohurive të studentëve në lidhje me programin e studimit. Biblioteka e Kolegjit Univesitar “Logos” është e pajisur me literaturë

(fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	mësimore në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj pasi janë vlerësuar nevojat dhe kërkesat e departamentit. Biblioteka ka literaturë fizike, tekste mësimore dhe literaturë plotësuese. Ky fond i bibliotekës pasurohet me botime periodike. Të gjitha tekstet dhe materialet e rekomanduara në syllabuset e programit gjenden fizikisht në bibliotekën e institucionit duke garantuar akses për studentët dhe stafin. <i>(Shtojca nr 25: Biblioteka; Shtojca nr 2: Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjithë elementët e nevojshëm)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kolegji Universitar “Logos” ka vënë në dispozicion bibliotekën e Kampusit nr. 1 me një sipërfaqe 173 m² me 40 poste leximi dhe 18 poste të pajisura me kompjutera me të gjitha programet e nevojshme për ruajtjen e cilësisë së studimit. Aksesi dhe mundësia për të shfrytëzuar informacionin e kësaj biblioteke është e plotë për të gjithë studentët dhe kjo vihet re jo vetëm në aksesin në orare, por edhe mundësinë për të aksesuar tituj dhe botime të ndryshme apo për të shfrytëzuar mjediset e saj. Biblioteka numëron 234 823 mijë libra në gjithën shqipe, greke dhe angleze, frenge, gjermane, italiane, sllave etj., duke mundësuar kështu një hapësirë të plotë për të gjithë studentët. Biblioteka ka po ashtu mundësi të aksesojë tituj edhe të Universitetit të Pireut përmes browserit: http://www.lib.unipi.gr/. Studentët trajnohet po ashtu për përdorimin e fondit të bibliotekës në shërbim të procesit mësimor. <i>(Shtojca nr 25: Biblioteka)</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e Kolegjit Universitar “Logos”, ka një fond të pajisur me tekste mësimore dhe literaturë bazë në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja. Numri i titujve dhe botimeve fizike janë në një numër të lartë duke ofruar mundësi për shfrytëzim shumë të mirë nga studentët dhe stafi. Programit të studimit i është vënë në dispozicion një bibliotekë e pasuruar me libra që kanë ardhur si rezultat e përgjigjes së materialeve bazë dhe ndihmëse të kërkuara nga përmbajtja e programi të studimit. Biblioteka ka ndërmarrë dhe nisma për nxitjen dhe pasurimin e bibliotekës me materiale, botime në vazhdimësi. <i>(Shtojca nr 25: Biblioteka), (Shtojca: Lista e teksteve në Bibliotekë)</i>
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për	Kolegji Universitar “Logos”, ka mundësuar akses pa pagesë në literaturë online të bibliotekave ndërkombëtare si Questia, EBSCO, JSTOR.

studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Mundësia për të bashkëpunuar me Universitetin e Pireut ka krijuar hapësirë për të shfrytëzuar pa pagesë bibliotekën e këtij insitucioni duke rritur potencialin për kërkim dhe përmirësim të procesit mësimor Kolegji Universitar “Logos” ofron edhe akses në revista ekonomike periodike si Monitor në format digjital.
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Biblioteka ofron mundësi të barabartë dhe aksesueshme të posteve të leximit, kompjuterave me mundësi akses në internet. Nuk ka asnjë kufizim në shfrytëzimin e këtij fondi dhe kësaj hapësire. Studentët janë të lirë të shfrytëzojnë të gjitha kapacitet që ofron biblioteka për përmbushjen e detyrimeve të tyre përgjatë procesit mësimor por edhe për studime dhe kërkime të tjera. Kjo bibliotekë ka implementuar baza elektronike në të cilën pasqyrohet fondi total i bibliotekës. Ky proces ka mundësuar katalogimin e fondit të bibliotekës duke ndihmuar aksesimin e të fondit të saj. Kjo është realizuar përmes kataloguesit elektronik PLEIADES bazuar në standartin MARC 21 (http://lib-orthodoxalbania.org). (Shtojca nr 25: Biblioteka)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Kolegjit Universitar “Logos”, është e frekuentueshme gjatë gjithë vitit, përveç ditëve të pushimit të festave zyrtare. Ajo ofron shërbim nga ora 08:00 - 20:00, orar ky fleksibël për studentët e programit. Regjistrimi i studentëve behet përmes anëtarësimit duke mundësuar kështu jo vetëm aksesimin e hapësirave të bibliotekës për të punuar dhe shfrytëzuar mjediset e bibliotekës, por edhe për të huazuar tituj të ndryshëm për t'i shfrytëzuar jashtë bibliotekës. (Shtojca nr 25: Biblioteka)
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit	Marrëdhënia e stafit akademik dhe studentëve si edhe për stafit përgjegjës për zhvillimit të programit të studimit 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhimin e Produktit Bujqësor” dhe “Meaxhimin e Fermës Bujqësore”, është aktive duke derguar propozimet e stafit me tituj dhe propozim për pasurimin e aktivitetit të bibliotekës. Ky është një proces i përvitshëm midis stafit të programit dhe atij të bibliotekës. Megjithatë biblioteka nuk raporton në mënyrë të dedikuar raporte në lidhje me funksionimin e problematikave, numrit të studentëve dhe formave të shfrytëzimit të mjediseve të saj. Duket që ky proces është kryesisht i njëanshëm vetëm nga ana e stafit akademik dhe përgjegjësve të programit që ofron institucioni.

fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.				
Konkluzione	<i>Biblioteka e Kolegjit Universitar "Logos" nuk raporton në mënyrë të dedikuar raporte në lidhje me funksionimin e problematikave, numrit të studentëve dhe formave të shfrytëzimit të mjediseve të saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	Institucioni Kolegji Universitar "Logos", ofron një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin në lidhje me studentët dhe performancën e tyre në mënyrë të lehtë të aksesueshme dhe transparente. Kolegji mundëson infrastrukturë elektronike që nëpërmjet platformave online të mundësojnë komunikimin ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Dokumentimi i informacionit për studentët realizohet përmes sistemit Edupage. Të dhënat ruhen në format xlsx duke shërbyer edhe si garantues i sigurisë së informacionit. Sekretaria mësimore me ndihmën e këtij sistemi gjeneron dhe ruan statistika vjetore në lidhje me numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit, të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet, të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, të dhëna për ecurinë akademike të studentit, numrin e krediteve të grumbulluara për secilin vit akademik, të dhëna për studentët e diplomuar. Po ashtu, Edupage mundëson pasqyrimin e vlerësimit interaktiv të studentëve me stafin akademik duke pasqyruar pikëzimin për çdo student sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në syllabus. Çdo student mund të logohet në http://www.kulogos.edupage.org përmes një username dhe password. Gjithashtu ofrohet edhe mundësia për tu identifikuar përmes software Microsoft office 365, përmes logimit me usernale dhe password.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Përdorimi i sistemi të brendshëm Edupage mundëson që i gjithë informacioni i brendshëm të kalohet përmes të gjithë pjesëtarëve të institucionit për nevoja të ndryshme në mënyrë të sigurtë dhe të shpejtë. Vihet re se secili anëtar mund të përdorë këtë sistem duke aksesuar individualisht përmes llogarisë së tij personale aktivitetin e përditshëm në këtë program si psh., hedhja e vlerësimeve në klasat përkatëse. Informacioni targetohet dhe ruhet përsëri në sistemin xlsx. duke mundësuar krijimin e një mbështetje të sigurisë.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ruajta dhe shpërndarja e informacionit realizohet përmes një sistemim operues efikas informimi, që duke ndjekur natyrën dhe destinacionin e tij kategorizohet në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm sipas specifikës. Informacioni që ruhet është regjistrim digjital i notave, krijimi i klasave mësimore, kontrolli i vlerësimeve nga sekretaria, gjenerimi i raporteve dhe statistikave të ndryshme. <i>(Shtojcë nr 33.3: Mjetet e komunikimit me studentët)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në funksion të aktivitetit të ruajtjes së të dhënave dhe informacionit Kolegji Universitar “Logos” përdor paketën Microsoft Office 365 Academic përmes sistemit Microsoft teams. Ky i fundit mundëson interaktivizimin për procesin e ruajtjes së leksioneve, detyrave, provimeve dhe për komunikime të tjera në lidhje me procesin mësimor. <i>(Shtojca: Komunikimi në Teams)</i> Kjo platformë përdoret përmes web-it ose aplikacioneve të ndryshme si MacOS, Linux, Android, etj. Programi Edupage mundëson gjithashtu edhe menaxhimin e regjistrave, grafikut të provimeve, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën paradiplomim, dhe diplomim nepërmjet sistemit digjital Edupage dhe Microsoft 365 Academic. Studenti ka mundësi të aksesojë informacion rreth tij në lidhje me ecurinë e performancën në procesin mësimor përmes llogarisë individuale duke ndervepruar për problematika të ndryshme me stafit akademik dhe sekretarinë. Përmes sistemit sekretaria depoziton edhe të dhëna personale të studentit për përmirësimin e procesit mësimor dhe dokumentar.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të	Ndërtimi i sistemeve që Kolegji Universitar “Logos” përdor mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Platforma Microsoft Teams i jep mundësi jo vetëm bashkëpërpimit të stafit akademik dhe studentit, por edhe depozitimit në kohë reale të materialit mësimor, detyrave dhe komunikimit të shpejtë për njoftime të ndryshme mes

dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	palëve.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Kolegji Universitar “Logos” në faqen e tij zyrtare http://www.kulogos.edu.al , ofron informacion në 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) ku bëhet publik dhe transparent informacioni në lidhje me mënyrën e funksionimit të institucionit, strukturën organizative, veprimtaritë, bazën ligjore, njoftime me karakter të ndryshëm të veprimtarive akademike shkencore, sociale, etj. http://www.kulogos.edu.al/al/index.html . Informacioni që mund të aksesohet në faqe lidhet me të dhëna të ofertës akademike, kriterëve të pranimit të studentëve, përmbatjes së programeve të studimit, informacionit në lidhje me stafin akademik, organigramën e strukturës së fakulteteve, departamenteve, orarin mësimor, skedulin e provimeve. Po ashtu mund të aksesohet edhe informacion në lidhje me njoftime të ndryshme, aktivitete dhe veprimtari me karakter profesional, social etj			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Logos” disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Kolegji Universitar "Logos" në përputhje me politikat dhe strategjitë e tij të zhvillimi harton buxhetin duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucion paracakton nevojat financiare duke përfshirë edhe nevojat që rrjedhin prej aktivitetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit 2- vjeçar profesional në Agrobiznes me profile në "Menaxhimin e Produktit Bujqësor" dhe "Meaxhimin e Fermës Bujqësore". Nisur nga nevojat bëhet edhe shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre bazuar në ligjin Nr 80/2015, (Neni 52/1/a). Pasi shqyrtohen dhe miratohen kërkesat e ardhura nga njësitë

	përgjegjëse hartohet buxheti me zëra konkretë. Ky projekt buxhet kalon në Senatin Akademik për miratim, për të kaluar më pas në Bordin e Administrimit të Kolegjit. Të ardhurat e Kolegjit Universitar “Logos” kanë qëndrueshmëri pasi sigurohen nga donacione përmes Fondacionit “Logos” përveç të ardhurave nga tarifat e studentëve. Donacionet mbulojnë shpenzimet e nevojshme për realizimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor si edhe për të nxitur dhe mbështetur studentët me sistemin e bursës. <i>(Shtojca: Tabelat e Akreditimit, Tabela 18).</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit i hartuar nga Kolegji Universitar “Logos” është konceptuar si një plan i të gjithë institucionit pa detajuar specifikat dhe zërat sipas programeve të studimit. Nga panorama e buxhetit total duken zërat për financimin e burimeve njerëzore, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet për studime dhe bursa, shpenzime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grante vendase dhe të huaja. Institucioni zbaton politkën e monitoritit të nevojave të njësive bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës akademike. Mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimor duke mbështetur stafin, mbulimin nevojave për sigurimin e burimeve njerëzore, mbështetjen e infrastrukturës etj. <i>(Shtojca: Mbështetja financiare për stafin, Parashikimi i buxhetit dhe mbështetja financiare për stafin)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në Kolegjin Universitar “Logos” strukturat administrative si Administratori dhe Zyra e Financës realizojnë procesin e auditimit të aktivitetit financiar për të siguruar monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të planit financiar të miratuar nga strukturat. Ky proces realizohet me përzgjedhjen e një Eksperti Kontabël të Autorizuar i cili kontrollon zbaton procesin e auditimit të jashtëm të institucionit duke zbatuar standartet ndërkombëtare të auditimit. Ky proces konkludon me një proces analitik të një raporti ku shprehen opinionet për pasqyrat financiare, politikat kontabël. Pasqyrat financiare depozitohen edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Raporti i auditimit financiar shprehet në përgjithësi për plotësimin e objektivave financiare të institucionit. Nëpërmjet të

	ardhurave të krijuara vlerësohet edhe përdorimi i tyre duke respektuar objektivat strategjike të institucionit. Pavarësisht kësaj në shtojcat referuese mungon një raport konkret që vlerëson realizimin e këtij procesi.			
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni kryen një analizë të raportit financiar në mbyllje të çdo cikli studimit duke bërë ndërhyrjet e nevojshme në shërbim të përmirësimit të procesit të financimit të aktivitetit. Nga ky raport, raportohet dhe bëhen ndërhyrjet e nevojshme për realizimet dhe mosrealizimet të zërave përkatës, pavarësisht se nga Shtojcat nuk tregohet se raportimi zbritet në nivelin e raportimit për njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Kolegji Universitar “Logos”, ka një stabilitet financiar duke qënë se siguron mbështetje nga Fondacioni “Logos” nëpërmjet themeluesit të tij, Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë. Burimet e financimit të këtij institucioni janë Fondacioni “Logos”, të ardhurat nga tarifat e studentëve, financim nga donacione të tjera. Fondacioni “Logos” konsiderohet një burim shumë i rëndësishëm për institucionit duke vlerësuar zëra si dhënia në huapërdorim të ambjenteve të 2 kampuseve, investimet në aspektin teknik dhe konstruktiv për mirëmbajtjen e ambjenteve mësimore. Duke qënë se në aktin e themelimit të Fondacionit “Logos” dhe Kolegjit Universitar “Logos” operon më një statut të një institucioi me karakter edukativ-mësimor suporti reflektohet në tarifat e shkollimit dhe mbështetjen e studentëve me bursa apo dhe lehtësimin e pagesave përgjatë vitit akademik.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Logos” disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni Kolegji Universitar “Logos” ka të mirë përcaktuar politikat dhe procedurat e nevojshme për mbulimin e të gjitha aspekteve që lidhen me ciklin e plotë akademik të studentëve nga pranimi e deri në diplomimin e tyre. Për këtë janë në funksion dokumente si Statuti i Kolegjit Universitar “Logos”. Rregullore e përgjithshme e KU “Logos”, Rregullore e programit të studimit 2 - vjeçar me karakter profesionale në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”. Këto rregullore përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me procesin e bërjes publike të kriterëve dhe kuotave për programin në faqen zyrtare të institucionit. http://www.kulogos.edu.al/al/admissions/html http://www.kulogos.edu.al/al/profesional/html <i>(Shtojca dosja nr 1: Rregullore e përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë që ofrojnë programin; Statuti i Kolegjit Universitar Logos; Shtojca nr 33.6: Rregullore mbi funksionimit të cështjeve studentore dhe Këshillimit të Karrierës; Shtojca 33.2: Vendim mbi ngritjen e komisionit mbi renditjen e aplikantëve, Shtojca nr 3: Rregullore e programit të Studimit me karakter profesional në Agrobiznes me profile në Marketing të Produktit Bujqësor dhe Menaxhim të Fermës Bujqësore)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kolegji Universitar “Logos” ndjek një politikë dhe harton procedura që garantojnë barazi dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët e regjistruar. Kjo vihet re në transparencën e bërjes së njoftimeve për procesin e përzgjedhjes, informacionin në lidhje me funksionimin e institucionit dhe përfitimit nga politikat mbështetëse të tij. Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me përmbajtjen e programit, me mënyrën e organizimit të tij, vlerësimin, detyrimet dhe të drejtat që ata gëzojnë, afatet e përfundimit dhe diplomimin e tyre. Politikat e barazisë dhe shanseve janë parashikuar në rregulloren e Kolegjit Universitar “Logos”, i cili sanksionon se stafi i Kolegjit gjatë punës së tij nuk mund të diskriminojë mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofie, fetare.

	Po ashtu institucioni garanton mundësinë për studentë të trojeve shqiptare jashtë kufijve territorial për ndjekjen e programi të studimit. Po ashtu politikat e mbështetjes me bursë garantojnë bërjen publike të kushteve për përfitimin e tyre nga studentët që plotësojnë kriteret e vendosura. http://www.kulogos.edu.al/al/admissions/html http://www.kulogos.edu.al/al/profesional/html (Shtojca Nr 33.3: Mjetet e komunikimit me studentët; Shtojca Nr 33.4: Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosje dhe Broshura të KU "Logos"; Shtojca nr 33.5: Rrjete Sociale)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret të qarta në lidhje me procesin e pranimit në programin e studimit 2 - vjeçar me karakter profesionale në Agrobiznes me profile në "Menaxhim të Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore". Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me përmbajtjen e programit, mënyrën e organizimit të tij, vlerësimin, detyrimet dhe te drejtat që ata gëzojnë, afatet e përfundimit dhe diplomimin e tyre. Institucioni po ashtu përdor një larmi formash për informimin e publikut në lidhje me procedurat përkatëse përmes faqes zyrtare, fletëpalosjet, leksionet e hapura me maturanët për konsultime për lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore, borshura informatike dhe aktivizimin e zyrës së këshillimit të karrierës. Po ashtu përdoren edhe mjetet të tjera si: Edupage, Facebook, adresat e stafit etj. (Shtojca Nr 33.3: Mjetet e komunikimit me studentët; Shtojca Nr 33.4: Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosje dhe Broshura të KU "Logos"; Shtojca nr 33.5: Rrjete Sociale)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat në lidhje me pranimin dhe përparimin e studentit në këtë program janë të qarta dhe transparente. Për këtë institucioni ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda fakultetit dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Institucioni konsideron se studentë të programeve të tjera të ngjashme të mund të kryejnë procesin e transferimit pasi të kalohet në komisionin <i>ad-hoc</i> të ngritur për vlerësimin e krediteve, njohjen e plotë ose të pjesshme të tyre. Kolegji bën publik çdo vit kriteret dhe kuotat si edhe të gjitha procedurat dhe kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të

	Ministritë së Arsimit dhe Sportit dhe agjencive kompetente. http://www.kulogos.edu.al/al/admissions/html (Shtojca dosja nr 1: Rregullore e përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë që ofrojnë programin; Statuti i Kolegjit Universitar Logos)			
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Kolegji Universitar “Logos” ndjek një politikë nxitëse dhe mbështetëse të studentëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave në nevojë veçanërisht për programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes. Kjo pasqyrohet në politikën dhe misionin e programit të studimit. Kolegji së bashku me Fondacionin “Logos” bën publike një kohë të dedikuar studentëve me aftësi të veçanta duke bërë informimin në faqen zyrtare. http://www.kulogos.edu.al/al/admissions/html (Shtojca Nr 33.3: Mjetet e komunikimit me studentët)			
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Kolegji Universitar “Logos”, ndjek një politikë të ndihmës apo bursave të plota për të nxitur pranimin në programe me përparësi. Bursat e ofruara ofrohen në formën e bursave sociale si edhe të bursave të meritës. http://www.kulogos.edu.al/al/news.html			
Konkluzione	Kolegji Universitar “Logos”, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të	Institucioni Kolegji Universitar “Logos” vendos në dispozicion të studentëve informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për kalimin nga njëri vit akademik te tjetri. Për këtë studenti njoftohet për numrin e krediteve, notën minimale kaluese etj. Kriteret bëhen publike në website e

studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	insitucionit, studentët orietohen nga një anëtar i stafit i caktuar si tutelë për veprimtarinë dhe njoftimet e studentëve. Informacioni vihet në dispozicion përmes rregullores së përgjithshme të institucioni si edhe rregulloret përkatëse. Po ashtu për të rritur përshtatjen e studentëve të rinj, insitucionit siguron edhe më shumë informacion përmes aktivitetit të përvitshëm “Njiu me Kolegjin Universitar “Logos”. Një kujdes tregohet edhe në krijimin e një pakete informimi me të dhëna si paketa rregullative, platforma teknologjike Edupage, Microsoft Teams etj. Institucioni angazhohet të marrë kontakte me studentët përmes takimeve me stafin e programit po ashtu edhe dekanin. Takimet dhe kontaktet më të shpeshta krijojnë mundësi për shpërndarje të informacionit dhe trajtimin të tij sipas nevojave të studentëve (2 studentë për vitin akademik 2023-2024, dhe 1 student për vitin akademik 2022-2023). http://www.kulogos.edu.al/ <i>(Shtojca dosja nr 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë, Shtojca 33.7: Njiu me Kolegjin Universitar “Logos”)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Kolegji Universitar “Logos”, në programin e tij profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” respekton të drejtën që garanton Ligji i Arsimit të Lartë, 80/2015, përmes njohjes së krediteve midis programeve të njejta apo të ngjashme në të njëjtën cikël studimi. Procedura e njohjes kalon përmes krijimit të grupeve të punës që angazhohen në vlerësimin e procedurës. Komisionet <i>ad-hoc</i> si komisione të Transferimit funksionojnë mbi bazën e një rregulloreje transferimi dhe njoftimet përkatëse bëhen publike në faqen e web të Kolegjit Universitar “Logos”. <i>(Shtojca dosja nr 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë, Shtojca 33.8: Udhëzim (rregullore) e transferimeve)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kolegji Universitar “Logos” siguron informacion të bollshëm në lidhje me informimin e studentëve për kriteret e procedurat e vlerësimit. Kjo realizohet në disa drejtime. Së pari aksesimi i formatit të syllabusit ku janë të pasqyruar elementët e vlerësimit, takimi me studentët dhe stafin akademik, kordinatorin dhe stafin përgjegjës për ndjekjen e praktikës. Ky informacion gjithashtu bëhet i aksesueshëm përmes platformave si Edupage dhe Microsoft Teams. http://teams.microsoft.com/#school/teams-

	rid/Genetal?ctx=teamsGrid <i>(Shtojca Dosja 2: Dosja e programit të Studimit me të gjithë elementët e nevojshëm, Shtojca 33.9 Vendime të Dekanit të Fakultetit Ekonomik për caktimin e Kordinatorëve)</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e përgjithshme, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e programit të studimit përcakton qartësisht procedurat e organizimit të provimit përfundimtar. Këto rregullore përcaktojnë kohën dhe mënyrën e informimi të studentëve rreth zhvillimit të provimit përfundimtar. Po ashtu studentëve u ofrohet një bashkësi pyetjesh orientuese për kontrollin e njohurive në provimin e diplomimit. <i>(Shtojca 33.10: Njoftime për bankën e pyetjeve për provim formimi; Shtojca dosja nr 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Kolegji universitar “Logos” organizon punën për të rritur kontaktin me persona të interesuar për programet e studimit. Ky insitucion organizon fushata të gjera informimi në web si edhe ngre grupe pune për organizimin e fushatë së informimit në funksion të këshillimit të karrierës dhe rekrutimit të kandidatëve. Për këtë janë përdorur mjete të ndryshme si fletëpalosje, broshura, ditë informimi, ditë të hapura etj. Të interesuarit ftohen të vizitojnë mjediset e institucionit dhe të informohen në lidhje me programin e studimit, përfitimet, avantazhet dhe mundësitë që lehtësojnë ndjekjen e një programi të tillë. <i>(Shtojca 23: Aktivitete të FE)</i>			
Konkluzione	Kolegji universitar “Logos” vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	Studentët e programit të studimit 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit

hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”, organizohet në fillim të çdo viti akademik përmes aktivitetit “Njihu me kolegjin universitar Logos”. Përmes këtij aktiviteti bëhet njohja e studentëve me stafin akademik, sekretarët, strukturën, organizimin e kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjithashtu, janë aktive dhe organizmat studentorë si Këshilli Studentor, kordinatori i programit të cilët ndihmojnë me informacion studentët e sapoardhur. Po ashtu, në dispozicion të studentëve vihen edhe aktorë të tjerë si Kordinatori Akademik, Senatorët dhe informimet në mjediset e institucionit. Informimi në kohë reale kryhet përmes platformës Edupage, Microsoft Teams, adresave të stafit akademik duke rritur interaktivitetin me studentët për problematika të ndryshme. <i>(Shtojca 23: Aktivitete të FE, Shtojca 33.11: Statuti i Keshillit Studentor, Shtojca 33.12: Rregullore e Keshillit; Statuti i KU Logos)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e programit përgjatë takimit “Njihu me Kolegjin Universitar Logos” pajisen me dosjen e plotë të studentit e cila përfshin kartën e studentit, informacion në lidhje me programet e lëndëve si syllabuset, modulet, e veprimtarive formuese. <i>Shtojca 33.7: Njihu me Kolegjin Universitar “Logos”)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në Kolegjin Universitar “Logos” funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës si pjesë përbërëse e strukturës së Kolegjit Universitar Logos. Ajo ka si mision studentin në lidhje me organizimin e praktikës profesionale dhe suportimin për hulumtim në tregun e punës. Kjo zyrë së bashku më syrën e çështjeve studentore informon studentët në lidhje me mundësitë e punësimit, krijimit të CV-ve të përshtatshme, krijimit të mundësive për leksione të hapura me përfaqësues të kompanive, organizimit të panairëve Work & Study si edhe lidhjet me rrjetin e të diplomuarve Logos-Alumni. http://www.kulogos.edu.al/al/employment-and-intership.html <i>(Shtojca 33.13: Të dhëna mbi alumnit, statistika dhe analiza)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me çdo ndryshim që ndikon në procesin mësimor, logjistikës, infrastrukturës dhe shërbimet në funksion të realizimit sa më eficient të tij. Ata njoftohen nëpërmjet adresës së e-mailit dhe faqes zyrtare web, lidhur me orarin e mësimit apo ndryshimet e mundshme të tij, orarin dhe sallën e provimit, orarin e konsultimeve. Përdorimi i platformës Microsoft Teams dhe Edupage i krijon mundësi lektorëve të komunikojnë përmes

	krijimit të klasave për çdo informacion të nevojshëm në funksion të procesit mësimor. <i>(Shtojca nr Dosja 17: Procedura për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies)</i>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Studentët e programit 2- vjecar profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”, informohen nga nëjsia bazë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me çdo ndryshim të programit të studimit, praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen si dhe nga zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, ju bëhen vazhdimisht me dije mundësitë e punësimit të ofruara nga partnerët e Kolegjit Universitar “Logos”			
Konkluzione	<i>Kolegjin Universitar “Logos” vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.


Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Kolegji Universitar “Logos” disponon të dhëna statistikore vjetore të cilat përpilohen në fillim dhe përfundim të çdo viti akademik për programin e studimit me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”, të cilat i përcillen edhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Këto të dhëna ruhen elektronikisht dhe të printuara në zyrën e sekretarisë mësimore. Në këto të dhëna pasqyrohen: numri i studentëve, regjistrat e amzës/NIM librat themeltar të studentëve, librat e arritjeve akademike, librat e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <i>(Shtojca nr Disja 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë programin;</i>

	<i>Rregullore Arkiv-Protokoll)</i>			
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore e institucionit disponon satatistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit në lidhje me ciklet e studimit edhe për programin 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”. Ruatja e të dhënave bëhen në version të printuar dhe elektronike në sistemin e brendshëm të menaxhuar nga Kolegji Universitar “Logos”.			
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Ruajta e të dhënave të studentëve realizohet në mënyrë periodike në sekretarinë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm të institucionit. Nga dokumentacioni i referuar, raporti i vlerësimit dhe vizita në institucion, kontrolli periodik realizohet me analizat e statistikave që merren në shqyrtim, kjo mbështetur edhe nga proceset e akreditimit në të cilat është përfshirë insitucioni duke përmirësuar procesin e vlerësimit dhe dokumentimit të të dhënave dhe statistikave që lidhen studentët.			
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Mbledhja dhe ruajta e informacionit realizohet nga institucioni për ecurinë e aktivitetit, profilin dhe cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje, por nga dokumentacioni i raportuar mungon analiza e realizuar posaçërisht nga Departamenti i Agrobiznesist me të dhëna për avantazhet dhe problematikat që përball programi 2- vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Logos” mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Kolegjin Universitar “Logos”, i jep një rëndësi të veçantë përfshirjes së studentëve duke e parashikuar këtë premisë në statute dhe rregullore të ndryshme të institucionit. Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit si Senati Akademik dhe komisionet e tjera si për shëmbull ai i Sigurimit të Cilësisë. Përfshirja e tyre realizohet duke kaluar përmes një procesi zgjedhor ku studentët përfaqësues këshillojnë dhe sjellin mendimin e studentëve në organet vendimmarrëse. <i>(Shtojca nr 1 Dosja 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njëjësive kryesore dhe bazë)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Garantimi i përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik garantohej përmes Statutit të Kolegjit Universitar “Logos” duke mbështetur organizmat studentorë përmes monitorimit të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Mendimi i tyre në lidhje me problematikat e institucionit kryhet përmes koordinatorëve. Duke patur parasysh numrin e kufizuar të studentëve, mendimi i tyre për programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional në Agrobiznes me 2 profile në “Menaxhim i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”, është shumë i kufizuar. Instrumentat dhe mjetet për vlerësimin dhe praninë e mendimit të studentëve mbeten të pranishme në nivel institucioni. <i>(Shtojca nr 33.11: Statuti i Këshillit Studentor, Shtojca nr 33.12: rregullore e Këshillit Studentor)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Kolegji Universitar “Logos” dhe Departamenti i Agrobiznesit janë të angazhuar të përfshijnë studentët në vlerësimin e procesit akademik, nëpërmjet ngritjes së instrumentave matës për vlerësimin e mësimdhënies, mësimnxënies apo përmirësimit të programeve të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet plotësimit të formularëve të miratuar në nivel institucioni online, për çdo lëndë dhe lektor duke ruajtur anonimat. Opinionet dhe vlerësimet kontribuojnë në përmirësimin e procesit mësimor. Institucioni mbështet përfshirjen e studentëve në vendimmarrjet e çështjeve që trajtohen në Këshillin Studentor, Këshillin e Etikës, Njësne e Sigurimit të Cilësisë si dhe takimet me Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët dhe Komisionin e Përhershëm të Garantimit të



	Cilësisë. Monitorimi dhe vlerësimi realizohet përmes një formulari në sistemin Teams. Monitorimi bëhet 2 herë në vit në përfundim të çdo semestri. Me rezultatet e monitorimit përplohet një raport për çdo modul dhe pedagog. Ky raport përcillet si në nivelet drejtuese të Kolegjit Universitar "Logos" dhe në nivel departamenti për çdo pedagog.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Kolegji Universitar "Logos", ka të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme mundësinë që studenti të ankimojë rezultatin përfundimtar. Ky proces kalon disa procedura të parashikuara në rregullore nga paraqitja me shkrim deri në ballafaqimin me komisionin <i>ad-hoc</i> të ngritur për këtë qëllim. (Shtojca nr 1 Dosja 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë)			
Konkluzione	Kolegji Universitar "Logos" përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka ngritur procedura përmes Sekretarisë Mësimore, Departamentit të Agrobiznesit, Koordinatorit për Marrëdhëniet me Studentët të cilat janë të pranishme në Rregulloren e Kolegjit Universitar "Logos" dhe rregullore të Fakultetit Ekonomik. Roli i aktorëve të mësipërm realizohet përmes adresave të email-it, rrjetet sociale, platformat online. (Shtojca nr 1 Dosja 1: Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë; Shtojca 33.11: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës)

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Studentët e Kolegjit Universitar “Logos” kanë mundësi të informohen dhe marrin këshillim përmes një sistemi funksional në distancë si edhe përmes zyrave të posaçme të ngritura për t’i shërbyer këtij procesi. Faqja zyrtare e internetit garanton marrjen e informacionit në lidhje me funksionimin e procesit dhe programin e studimit. Po ashtu informacionet në lidhje me aktivitete si leksione të hapura, workshope, seminare, aftësime në lidhje me aftësimin e tyre në tregun e punës menaxhohen nga Zyra e Çështjeve Studentore duke komunikuar me studentët në vazhdimësi. http://www.kulogos.edu.al/al/news.html http://www.kulogos.edu.al/al/event.html (Shtojca 23: Aktivitete të FE)
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në Kolegjit Universitar “Logos”, zyra e Karrierës dhe e Çështjeve Studentore ka në mision të orientojë studentët në tregun e punës duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhillimin e plotë të potencialit të tyre. Kjo zyrë ndihmon për vitalizimin e marrëveshjeve të lidhura mes institucionit dhe organizmave të ndryshëm. Ndjekja dhe kujdesi për studentët gjatë periudhës së praktikës realizohet nga kjo zyrë në vijimësi.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik dhe më konkretisht me Departamentin e Agrobiznesit është në komunikim të vazhdueshëm me kompanitë për integrimin e studentëve në tregun e punës që nga realizimi i praktikës deri në punësimin e plotë ose të pjesshëm të tyre. Zyra vazhdon më tej komunikimin me kompaninë përmes një formulari ku merret në lidhje me integrimin e tyre në tregun e punës. Po ashtu kjo zyrë disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve. Vet studentët janë po ashtu pjesë integrale e procesit dhe duke i dhënë kështu mundësi studentëve të tjerë të njihen me punëdhënësit të ndryshëm. (Shtojca nr 33.13: Të dhëna ALUMNI 2021-2024)
Konkluzione	Kolegjit Universitar “Logos” ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e

	<i>ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të Studimit me Karakter Profesional në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Logos”

Pikat e forta dhe afirmime


1. Mbështetje e qëndrueshme financiare përmes Fondacionit “Logos”.
2. Kapacitete infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të nevojshëm për natyrën dhe fushën e programit të studimit.
3. Bibliotekë me literaturë fizike, tekste mësimore dhe literaturë plotësuese, që i jep akses dhe mundësi shfrytëzimi të plotë të gjithë studentëve.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit me biznesin, me potencial për orientimin e praktikave në lidhje me fushën profesionale të studentëve të programit të studimit.
5. Funksionimi formal i strukturave për sigurimin e cilësisë dhe hartimi periodik i raporteve të monitorimit të procesit mësimor dhe të programit të studimit.
6. Përdorimi i platformave digjitale (si EduPage dhe Teams) që mundësojnë komunikim dhe akses në materialet mësimore në kohë reale.

Pika të dobëta


1. Përmbajtja e lëndëve në programin e studimit mund të kishte vend për disa përmirësime në lidhje me përshtatjen e njohurive për kornizën së cilës i përket ky program studimi, duke përshtatur nivelin e temave dhe thellësisë së tyre në aspektin më praktik, jo vetëm teorik.
2. Numri në limitin e lejuar të stafit akademik, që në rastin e mbulimit të lëndëve rezulton me anëtar që kalojnë numrin maksimal të lëndëve të lejuara brenda një viti akademik.
3. Literatura mësimore në disa lëndë është e vjetëruar ose jo në përputhje me realitetin bujqësor të vendit, duke përfshirë referenca për kultura që nuk janë më pjesë e sektorit.
4. Praktikant profesional nuk janë ende të formalizuara mjaftueshëm dhe mungon dokumentimi i bashkëpunimeve të strukturuar me biznese bujqësore për realizimin e tyre.

Rekomandime

1. Përshtatja e përmbajtjes së lëndëve në programin e studimit drejt një orientimi më praktik, në përputhje me kuadrin në të cilin bën pjesë ky program.



2. Rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe përditësimi i literaturës mësimore për të eliminuar përmbajtjet e vjetruara apo të parëndësishme për kontekstin bujqësor shqiptar, dhe integrimi i njohurive të reja që pasqyrojnë zhvillimet bashkëkohore në agrobiznes.
3. Forcimi i përbërjes së stafit akademik me ekspertizë të qartë në bujqësi dhe teknologji agro-ushqimore, për të mbuluar me kompetencë temat që lidhen me prodhimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore.
4. Zbatimi sistematik i metodave inovative të mësimdhënies dhe pasqyrimi i tyre në syllabus, si mësimi i bazuar në projekte, punë praktike e integruar, simulime dhe përdorimi i teknologjive digjitale në mësimdhënie.
5. Formalizimi i plotë i procedurave të diplomimit dhe përfundimit të studimeve brenda rregulloreve të programit të studimit, për të siguruar transparencë dhe udhëzime të qarta për studentët dhe stafin akademik.
6. Hartimi i një plani të strukturuar për përmirësimin e praktikës profesionale, përfshirë bashkëpunime të formalizuara me biznese bujqësore dhe agro-përpunuese, si dhe integrimin e praktikës brenda moduleve mësimore dhe jo vetëm si komponent më vete.
7. Krijimi i mekanizmave formalë për mbledhjen e opinionit të studentëve dhe përfshirjen e tij në përmirësimin e procesit mësimor, sidomos përmes mjeteve alternative kur numri i studentëve është shumë i ulët.
8. Zhvillimi i mekanizmave më efektivë të sigurimit të cilësisë, ku rezultatet e monitorimit përkthehen në përmirësime konkrete në planifikim, përmbajtje dhe procesin e mësimdhënies.
9. Rritja e bashkëpunimit me sektorin privat dhe përfshirja e përfaqësuesve të tregut të punës në hartimin dhe rishikimin e programit për të siguruar përshtatshmërinë me kërkesat aktuale të tregut dhe garantimin e punësueshmërisë së lartë të të diplomuarve.
10. Hartimi dhe zbatimi i një plani të posaçëm për rekrutimin e studentëve me qëllim përmirësimin e regjistrimeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të programit. Ky plan duhet të synojë maturantët e shkollave të mesme profesionale dhe të përdorë forma efektive promovimi dhe orientimi për studentët.
11. Mungesa e integritetit të metodave moderne dhe inovative të mësimdhënies në syllabus, pavarësisht angazhimit formal të institucionit.
12. Procedura e diplomimit dhe mënyrat e përfundimit të studimeve nuk pasqyrohen qartë dhe plotësisht në rregulloret e programit të studimit.
13. Mungesa e një plani të strukturuar për rekrutimin e studentëve që do të ndihmonte në rritjen e regjistrimeve dhe në garantimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të programit.



Evaluation Conclusions for the Professional Study Program “Agrobusiness” with the Profiles “Marketing of Agricultural Products” and “Farm Management” offered by the Higher Education Institution “Logos University College”

Strengths and Affirmations

1. Stable financial support through the “Logos” Foundation.
2. Appropriate infrastructural capacities for the implementation of the teaching process of the study program and for the practical training necessary for the nature and field of the study program.
3. Library with physical literature, textbooks, and supplementary materials that provide all students full access and usage opportunities.
4. Cooperation agreements with businesses, with potential for guiding student internships in alignment with their professional field.
5. Formal operation of quality assurance structures and periodic drafting of monitoring reports on the teaching process and study program.
6. Use of digital platforms (such as EduPage and Teams), which enable real-time communication and access to teaching materials.

Weaknesses

1. The content of the courses in the study program could benefit from improvements to better adapt knowledge to the framework to which this program belongs, aligning the level and depth of topics with a more practical, not solely theoretical, focus.
2. The number of academic staff is at the allowable limit, and in some cases, staff members exceed the maximum number of courses permitted in a single academic year.
3. The teaching literature in some subjects is outdated or not aligned with the current agricultural reality of the country, including references to crops that are no longer cultivated in Albania.
4. Professional practice components are not yet sufficiently formalized, and there is a lack of documentation regarding structured collaborations with agricultural businesses for their implementation.

Recommendations

1. Adapt course content in the study program to a more practical orientation, aligned with the framework to which this program belongs.
2. Revise the content of syllabi and update teaching literature to eliminate outdated or irrelevant content for the Albanian agricultural context, and integrate new knowledge reflecting contemporary developments in agribusiness.
3. Strengthen the composition of academic staff with clear expertise in agriculture and agri-food technologies, to competently cover topics related to production, processing, and marketing of agricultural products.



4. Systematic implementation of innovative teaching methods and their reflection in syllabi, such as project-based learning, integrated practical work, simulations, and the use of digital technologies in teaching.
5. Complete formalization of graduation and study completion procedures within the study program regulations to ensure transparency and clear guidance for students and academic staff.
6. Develop a structured plan for improving professional practice, including formalized collaborations with agricultural and agro-processing businesses, and the integration of practice within course modules, not just as a separate component.
7. Create formal mechanisms for collecting student feedback and incorporating it into teaching improvement processes, especially through alternative tools when student numbers are very low.
8. Develop more effective quality assurance mechanisms, whereby monitoring results are translated into concrete improvements in planning, content, and teaching.
9. Increase cooperation with the private sector and involve labor market representatives in the design and revision of the program to ensure it aligns with current market demands and guarantees high employability of graduates.
10. Design and implement a dedicated recruitment plan aimed at improving student enrollment in the program and ensuring its sustainability. This plan should target graduates of vocational secondary schools and employ effective forms of promotion and student orientation.
11. Lack of integration of modern and innovative teaching methods into the syllabi, despite the institution's formal commitment.
12. The graduation procedure and methods for concluding studies are not clearly and fully reflected in the study program's regulations.
13. Structure an recruitment plan in place to increase student enrollment and ensure the long-term sustainability of the program

Two blue ink signatures are present at the bottom right of the page. The first signature is a stylized, cursive mark, and the second is a more formal, blocky signature.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

